



INSTITUTI PER STUDIMET
PUBLIKE DHE LIGJORE
Institute for Policy & Legal Studies
(ISPL/IPLS)

Për përgatitjen e këtij libri bashkëpunuan:
Arta Vorpsi, Migena Kondo & Sami Neza.

This publication has been produced with the financial assistance of the European Union. The contents of this publication are the sole responsibility of Institute for Policy & Legal Studies and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the European Union.

Ky publikim është përgatitur me asistencën financiare të Bashkimit Europian.
Përmbajtja e këtij publikimi është vetëm përgjegjësi e Institutit për Studime
Publike & Ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se
pasqyron pikëpamjen e Bashkimit Europian.

PRAKTIKA GJYQËSORE NË ÇËSHTJET E SHPIFJES



Ky projekt është financuar nga
Bashkimi European



Ky projekt u zbatua nga:
Instituti për Studime Publike & Ligjore

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
TUCI KUNDËR SHOQËRIA STANDARD SHPK.....	17
OLLDASHI KUNDËR BOLLINO, BASHA DHE MURATI	20
SHEHU KUNDËR XH. PEZA DHE SH. PEZA	23
BERISHA KUNDËR BALLA.....	26
SKEJA KUNDËR DEDA.....	29
VELIAJ KUNDËR GOXHAJ.....	33
POLLO KUNDËR BALLA.....	37
KOKËDHIMA KUNDËR OLLDASHI.....	40
SHOQËRIA “FERAR” KUNDËR VALIKAJ (FELAJ)	43
RULI KUNDËR TAHIRIT'	46
BOGA KUNDËR PANORAMA GROUP, RAKIPLLARI	49
MARKU KUNDËR KASO, GAZETA REPUBLIKA	53
KULIÇAJ KUNDËR TAHIRI	57
MALLTEZI KUNDËR BALLA	60
MALLTEZI, BERISHA KUNDËR TAHIRI	63
BASHKIA TIRANË KUNDËR DALIPI	70
PANGO KUNDËR TOP CHANNEL SH.A	73
BEGEJA ETJ KUNDËR BALLA	76
PERLESHA KUNDËR GAZETËS ZËRI I POPULLIT'	79
BREÇANI KUNDËR SHOQËRIA FOCUS PRESS DHE FOCUS MEDIA NEWS SHPK.....	82
VOKSHI KUNDËR TAHIRI	86
VELIAJ KUNDËR GOXHAJ.....	89
MALLTEZI KUNDËR BALLA	95
BEGEJA ETJ KUNDËR BALLA	101

SHOQËRIA TREGTARE STSA ALBANIA KUNDËR	
SHOQËRIA TREGTARE SHQIPTARJA.COM	104
SHOQËRIA “BELLA CONFEX” SHPK, BAZHDARI	
KUNDËR ZYRA PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT,	
KUNDËR GOXHAJ.....	106
JANI KUNDËR SELAMAJ.....	108
MALLTEZI, BERISHA KUNDËR TAHIRI	109
KOKËDHIMA KUNDËR BERISHËS	113
KOKËDHIMA KUNDËR BERISHËS	116
PEZA KUNDËR BERISHËS	119
RAMA KUNDËR BERISHËS	122
 DËMSHPERBLIMET E DHËNA NGA GJYKATA	
NË ÇËSHTJET E DEFAMACIONI	125
 FAKTORËT SPECIFIKË QË DUHET	
TË MERREN PARASYSH NGA GJYKATA	
NË PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË	128

HYRJE

Nga praktika e gjykatave të shkallës së parë, të apelit dhe në disa raste edhe të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë vihet re një tendencë për ta trajtuar në mënyrë të gjerë dhe elastike lirinë e shprehjes në raport me mbrojtjen e personalitetit ose privatisë së individit. Ky raport është thujse përherë në përpjestim të zhdrejtë, dukshëm në favor të lirisë së shprehjes, sidomos në rastet kur i padituri ose i akuzuari është politikan (deputet, ministër ose kryeministër) ose përfaqësues i medias (gazetar ose botues). Në pjesën më të madhe të çështjeve gjyqësore të analizuara, bie në sy se gjykatat bëjnë referim të vazhdueshëm tek jurisprudenca e GJEDNJ, madje edhe në rastet kur përfundimi në të cilin kanë arritur gjykatat shqiptare ka qenë i ndryshëm nga praktika e referuar. Megjithatë kjo gjë, pavarësisht shkallës dhe thellësisë së referimit, padyshim tregon për rritje të ndërgjegjësimit të gjyqtarëve të zakonshtëm tek detyrueshmëria e jurisprudencës së GJEDNJ dhe rolit që ka kjo e fundit për mbrojtjen e të drejtave të individit edhe me vendime që jepen ndaj shteteve të tjera.

Në shumicën e vendimeve të analizuara, gjykatat janë ndalur tek përkufizimi dhe rëndësia e lirisë së shprehjes si dhe ndikimin që ka ajo tek shoqëria por edhe institucionet publike. Gjykatat ka vendosur theksin tek roli që luan liria e shprehjes si mjet për të realizuar të drejtën e informimit të publikut. Për hir të së drejtës për informim, gjykatat kanë pranuar edhe rastet e kapërcimit të kufirit të sferës private duke i vënë rëndësi synimit final të deklaratave të bëra nga politikanët. Kështu, gjykatat kanë konstatuar se *“...Deklarimet e të paditurit me cilësinë e deputetit në rastin konkret nuk janë shpifje apo trillime të tij me qëllim për të diskredituar paditësat. Nga ana tjetër ajo janë jashtë interesit vetiak. Me cilësinë e deputetit dhe në përmbushje të kësaj detyre ai ka shprehur mendime dhe opinione të bazuara në disa prova e fakte të vërteta. Thelbi i deklarimeve të tij ka të bëjë me*

mbrojtjen e pronës publike kundër abuzimeve dhe veprimeve të paligjshme nga institucionet e shtetit...Shprehja e përdorur dhe e konsideruar si shpifje dhe fyerje për paditësin është një pjesë e deklaratës së bërë nga i padituri në ushtrimin e funksionit të tij si politikan dhe opozitar për t'i sqaruar popullit të tij me informacione dhe opinione të veta shkaqet që, sipas tij, kanë sjellë situata të rënda sociale dhe problematike për një pjesë të caktuar të shoqërisë shqiptare.”

Në këtë kuadër, është vlerësuar nga gjykata si e rëndësishme për opinionin e gjerë publikimi i të dhënave që lidhen me administrimin e pronave publike, pavarësisht se mund të preken elementë të sferës private: “.... I padituri në cilësinë e deputetit të opozitës ka lirinë e shprehjes së opinioneve dhe gjykimeve të tij, madje duke lejuar deri diku edhe ndonjë tepri. Nga ana tjetër, pavarësisht se paditësi është ndierë i fyer në nderin dhe personalitetin e tij, kjo nuk mjafton për ta cilësuar veprimin e të paditurit si të kundërligjshëm. Deklaratat e bëra nga i padituri dhe të cilësuara nga paditësi si shpifje, në gjykimin e gjykatës së apelit, nuk vlerësohen të tilla, për sa kohë që ato e kanë një bazë faktike për shkak të së cilës janë bërë publike. Në cilësimin e veprimeve të të paditurit, gjykata e apelit, ndryshe nga ajo e shkallës së parë gjykon se qëllimi i vërtetë i të paditurit ka qenë shprehja e opinionit të tij dhe partisë që përfaqëson, lidhur me keq qeverisjen dhe posaçërisht mënyrës së administrimit të pasurive publike.”

Megjithatë në disa raste (më të pakta këto) gjykatat nuk kanë ngurruar të përcaktojnë vendosin edhe kufijtë e kësaj lirie duke përcaktuar se “...liria për t’u shprehur garantohet nga Kushtetuta por deri ne kufirin e paprekshmerise se dinjitetit dhe personalitetit te individit... Gjykata i jep prioritet mbrojtjes së moralit dhe interesit publik duke pranuar një standard të ndryshëm gjykimi në rastin e paditësit si politikan dhe person publik...Funksioni dhe detyra e deputetit lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë mbrojtje nga neni 73 i Kushtetutës, pasi nuk është në misionin e deputetit të bëjë akuza publike për fakte konkrete duke thënë gjëra të pabazuara dhe disinformuese. I padituri, nisur nga funksioni që ka dhe në emër të interesit publik nuk mund të disinformojë apo të cenojë me qëllim individët pa respektuar parime të së drejtës të tilla si prezumimi i pafajsisë apo barrën e provës për akuzat që ngrenë.”

Është për t'u vlerësuar fakti që gjykatat kanë trajtuar në mënyrë teorike konceptin e lirisë së shprehjes të garantuar nëpërmjet mjeteve të informimit publik në një demokraci duke evidentuar se *“Organet e shtypit kanë detyrimin të paraqesin faktet në mënyrë të vërtetë e jo të disinformojnë opinionin publik ose ta shtrembërojnë jashtë çdo imajinate, siç ka ndodhur në rastin konkret. Roli i medias është i rëndësishëm, pasi informon publikun e gjerë për të qenë kritikë ndaj politikanëve. Pa një rol të tillë shoqëria do të ishte e pamundur të kontrollonte sjelljet e funksionarëve dhe rrjedhimisht nuk do të krijonte dot asnjë përfytyrim tjetër përveç asaj që do t'i ofronin vetë këta funksionarë. Gazetari dhe media kanë detyrën për të informuar publikun për fakte me interes për të pa u shkaktuar dëm të tjerëve dhe pa thënë gjëra të pavërteta ose të pabazuara në fakte. Një sjellje e tillë nga personi që shkruan thënie të pabaza dhe cënues do të thotë të bësh atë që njeriu i arsyeshëm nuk do ta kishte bërë ose të mos bësh atë që njeriu i arsyeshëm do të kishte bërë. Njeriu me arsye mesatare nuk parashtron fakte të pabaza në drejtim të askujt. E drejta për të informuar publikun mbaron aty ku fillon e drejta e tjetrit që të mos i cenohet në mënyrë të paligjshme nderi personaliteti dhe reputacioni e jeta private nga shprehje fyese dhe të pavërteta... Deklarimet e të akuzuarit me cilësinë e një gazete nuk janë shpifje apo trillime të tij me qëllim për të diskretitur paditësat por me dhënien e informacionit ndaj publikut lidhur me aktivitetin e një organi publik dhe mbrojtjen e interesave shtetërore kundër abuzimeve dhe veprimeve të paligjshme nga institucionet e shtetit. Gjykata vlerëson se qëllimi i mbrojtjes së individit nga veprat e fyerjes dhe shpifjes nuk është mbrojtja e interesave ekonomike dhe pasurore të personit por janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar dinjitetin e personit apo emrin e mire dhe reputacionin e personit juridik, si të drejta jopasurore*

Gjykata ka shkuar edhe më tej duke theksuar se *“Deklaratat të cilat nuk paraqesin realitetin synojnë të ndikojnë negativisht në opinionin e komunitetit duke mbajtur në vëmendje se shtypi viziv dhe jo viziv, si pushtet i katërt, ka një influencë të rëndësishme në opinionin e qytetarit. Megjithëse pala paditëse duhet të jetë e përgatitur të përballojë deklarata të ndryshme, në rastin e shprehjeve të pavërteta sidomos kur lidhen me afera korruptive, ajo ka të drejtë të gëzojë mbrojtje për cenimin e nderit dhe personalitetit. E kundërta do të thotë që dëmi që i vjen palës paditëse është më i madh se përfitimi që ka shoqëria nga ushtrimi pa kusht i së drejtë së*

shprehjes...Informacioni i botuar duhet të jetë i vërtetë dhe autentik, pra të ketë përputhshmëri midis fakteve që kanë ndodhur dhe atyre që tregohen, të ketë interes publik në atë që tregohet dhe korrektesë në botim me qëllim parandalimin e prekjës së dinjitetit dhe personalitetit të individit.”

Gjykata madje në një rast ka marrë guximin të bëjë një dallim midis koncepteve ‘fakt’ dhe ‘opinion’ në mënyrë që të arrijë në përfundimin se a ka apo jo shqipfje. Kështu ajo ka konstatuar se “... Dallimi midis atyre që quhen fakte dhe opinione është i qartë: opinionet janë pikëpamje personale të një ngjarje apo situata, faktet mbi të cilat bazohen opinionet duhet të provohen si të vërteta. Ekzistenca e fakteve mund të dëshmohet, kurse vlerësimet nuk mund të dëshmohen. I gjithë informacioni i dhënë nuk i është nënshtruar verifikimit për vërtetësinë e tij.”

Megjithëse siç u tha më lart, gjykatat kanë qenë kryesisht të prirura për të zgjeruar sa më shumë kuptimin dhe hapësirën e mbrojtur nga liria e shprehjes, ato nuk kanë lënë jashtë vëmendjes mbrojtjen e personalitetit të individit. Ato kanë theksuar në mënyrë të vazhdueshme se “E drejta e personalitetit ka për objekt mënyrën e jetesës fizike apo morale të individit. Personaliteti i tij manifestohet në shoqërinë ku ai jeton dhe për rrjedhim është kjo e fundit që njeh dhe vlerëson vlerat e dinjitetit njerëzor. Në këtë kuptim cenimi i personalitetit dhe dinjitetit duke shkakuar dhimbje të brendshme e vuajtje shpirtërore si individë dhe anëtarë i shoqërisë të shkaktuar nga vepra e paligjshme e të paditurit përbën cenim të të drejtave të personalitetit të mbrojtur nga Kushtetuta.”

Gjykata ka vlerësuar se “liria e shprehjes garantohej nga Kushtetuta por deri në kufirin e paprekshmërisë së dinjitetit dhe personalitetit të individit. I padituri gjatë shprehjes duhet të kishte respektuar disa parametra. Informacioni i dhënë prej tij duhej të ishte i vërtetë dhe autentik, që nënkupton përputhshmëri midis fakteve që kanë ndodhur dhe fakteve që tregohen, të ketë interes publik në atë që tregohet dhe korrektesë në transmetimin e fakteve me qëllim parandalimin e prekjës së dinjitetit dhe personalitetit të individit...Nderi dhe personaliteti i një individi është masa e vlerësimit që shoqëria krijon për individin ose personin publik. Ky vlerësim krijohet nga vetëqendrimet dhe veprimtaria që shfaq individi në publik. Nderi dhe personaliteti pozitiv krijohen kur veprimtaria e individit bazohet në sjellje të moralshme dhe respektimit të individëve të tjerë. T’i atribuosh

individit sjellje të pagena dhe që krijojnë një opinion negativ përbën cenim të nderit dhe personalitetit.”

Gjykatat në disa raste kanë bërë edhe ndarje të konceptit të përgjegjësisë penale dhe asaj civile në lidhje me shkaktimin e dëmit dhe shpërblimin lidhur me të por edhe sa i takon barrë së provës. Në lidhje me barrën e provës, gjykatat kanë theksuar se “Në dallim nga e drejta penale që bazohet në prezumimin e pafajësisë, e drejta e detyrimeve në lidhje me shkaktimin e dëmit bazohet në prezumimin e fajësisë duke pasur paditësi detyrimin për të provuar vetëm që deklaratimet e të paditurit i kanë cenuar nderin dhe personalitetin dhe barra e provës kalon tek i padituri për të provuar faktet që janë në themel të deklaratimeve të tij. Në gjykimin civil dhe të drejtën e detyrimeve në dallim nga e drejta penale, vlen parimi i prezumimit të fajësisë. Paditësi ka detyrimin vetëm të provojë deklaratimet e të paditurit që i kanë cenuar nderin dhe personalitetin e pastaj barra e provës për të provuar faktet që qëndrojnë në bazë të deklaratimeve bien mbi palën e paditur. Për të provuar ekzistencën e këtij dëmi, mjafton edhe vetëm fakti i paraqitjes së padisë në gjykatë gjë që provon se cenim i botës së brendshme të paditësit e ka detyruar atë t’i drejtohet me padi gjykatës për të rivendosur në vend të drejtën e cenuar...Investimi i gjykatës, bazuar në nenin 59 të KPP, është një e drejtë tërësisht e të dëmtuarit akuzues dhe kusht themelor për zhvillimin e gjykimit. Është gjithashtu detyrimi i të dëmtuarit akuzues të paraqesë provat mbi të cilat mbështet akuzën e ngritur. Ndërsa i akuzuari prezumohet i pafajshëm derisa të provohet e kundërta nga i dëmtuari akuzues.”

Në një rast, gjykata është shprehur se në çështjet që lidhen me publikimin ose denoncimin publik të shkeljeve ose veprimeve abuzive, nuk është e domosdoshme ose e vetmja mundësi që i padituri t’i drejtohet organit të prokurorisë për fillimin e ndjekjes penale. Sipas gjykatës, “Ky qëndrim do të çonte në një situatë, në të cilën asnjë dyshim apo pretendim i politikanëve apo medias, për abuzime me pushtetin dhe kundërshtimet lidhur me mënyrën e veprimit të qeverisë, nuk do të duhej të bëheshin publike apo të shtroheshin për diskutim të gjerë, ndërkohë që si roli i politikanëve ashtu edhe ai i medias, në një shoqëri demokratike është ai i monitoruesit publik, bërjes së opozitës lidhur me qeverisjen dhe do të ishte e papranueshme që këto subjekte të privoheshin nga e drejta për të ndarë me publikun çështje të rëndësishme për të, vetëm

nga fakti se nuk do bëhej e mundur të vërtetohet në detaje vërtetësia e deklarimeve.”

Në lidhje me shpërblimin e dëmit gjykatat kanë marrë parasysh disa elementë për caktimin e tij, ashtu siç ka patur edhe raste kur gjykatat nuk kanë vlerësuar asnjë element ose vetëm disa prej tyre por pa i detajuar ato duke dhënë një dëmshpërblim apriori. Kështu, është vlerësuar se *“shpërblimi ka më së shumti efekt ndëshkues dhe jo efekt rimbursues për paditësin. Efektin rimbursues për paditësin e luan vetë ky vendim gjyqësor i cili një padrejtësinë dhe pavërtetësinë e këtyre thënierve.*

Më tej, gjykatat kanë vlerësuar koncepte të tilla si dëmi ekzistencia dhe dëmi moral (më rrallë). Sipas tyre, *“Dëmi ekzistencial nënkupton cenimin e vlerave komplekse të qenies njerëzore, të normalitetit dhe cilësisë së jetës së njeriut, të ndjenjave dhe të solidaritetit reciprok brenda familjes si dhe shprehjes së lirë e të plotë të aftësive të qenies njerëzore për të zhvilluar personalitetin për tu shfaqur në shoqëri në kuadër të njësisë bazë të saj: familjes. Paditësi duhet që pas publikimit apo transmetimit të informacionit të rremë dhe jo autentik të provonte përkeqësimin e cilësisë së jetës apo mënyrën e jetesës individuale.”* Pra, gjykata kërkon të provohet ardhja e pasojave të dëmshme me qëllim dëmshpërblimin.

Ndërsa në një rast tjetër, gjykata nuk e sheh të nevojshme një kriter të tillë. Kështu, ajo thekson se *“Për të provuar ekzistencën e këtij dëmi, mjafton edhe vetëm fakti i paraqitjes së padisë në gjykatë gjë që provon se cenim i botës së brendshme të paditësit e ka detyruar atë t'i drejtohet me padi gjykatës për të rivendosur në vend të drejtën e cenuar.”*

Lidhur me masën e dëmshpërblimit, gjykatat nuk kanë ndonjë formulë konkrete mbi bazën e të cilës të llogarisin atë. Në çdo rast gjykata bën një vlerësim në bllok duke caktuar një masë fikse, kryesisht simbolike dhe në asnjë rast nuk është pranuar shuma e kërkuar nga paditësi/i dëmtuari akuzues. Por ajo ka konstatuar se... *Fakti që paditësit kanë të ardhura të konsiderueshme nuk mund t'u mohojë atyre të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim për dëmin jopasuror. Morali dhe dinjiteti i personit nuk ka çmim dhe nuk ka formulë llogaritëse, por gjykata në caktimin e saj nisët nga kritere dhe praktika tashmë të konsoliduara.”* Në një rast tjetër, *“Sa i takon masës së dëmshpërblimit, Gjykata vlerëson se ajo duhet të marrë në konsideratë cenimin e personalitetit dhe dinjitetit të paditësit si dhe të jetë i mundshëm*

për tu ekzekutuar si dhe edhe gjendjen shoqërore, e motive dhe psikologjike të të paditurit.”

Konkretisht, sa i takon masës së dëmshpërblimit, gjykata kanë vlerësuar se ajo duhet të marrë në konsideratë disa elementë:

- cenimin e personalitetit dhe dinjitetit të paditësit
- mundësia për t’u ekzekutuar.
- përkeqësimi i cilësisë së jetës apo mënyrës së jetesës individuale.
- gjendja shoqërore, emotive dhe psikologjike
- përhapja e shpejtë e thënieve
- mospranimi i bërjes së përgenjeshtrimit nga i padituri
- rëndesa e akuzave,
- personaliteti social i paditësit,
- pozitën e të paditurit,
- të ardhurat e të paditurit,
- proporcionalitetin midis masës së dëmshpërblimit dhe dëmit të shkaktuar

Nga analiza vihet re se jo në të gjitha rastet janë marrë parasysh kriteret e mësipërme. Në disa raste është konstatuar një analizë e përciptë e elementëve që çojnë në përgjegjësinë civile ose penale të të paditurit ose të të akuzuarit duke mos krijuar qartësi në vendimmarrje. Në raste të tjera, mënyra e përcaktimit të dëmshpërblimit, megjithëse është evidetuar shkelje/faj, ka qenë e paqartë ose e pamatshme.

Duhet thënë se gjykatat në shumicën e rasteve kanë vlerësuar se ka një raport të drejtë sipas tyre, midis shkeljes ose pasojës negative të ardhur nga thëniet e pavërteta ose fyese dhe dëmshpërblimit të akorduar në fund të gjykimit, si e vetmja mënyrë për të kthyer gjendjen e mëparshme ose për të minimizuar sadopak situatën negative emocionale psikologjike të paditësit. Kështu, gjykatat kanë vlerësuar se “... dëmshpërblimi duhet të synojë kthimin e gjendjes së mëparshme të personit të dëmtuar.” Gjithashtu, gjykata ka mbajtur parasysh edhe rrezikshmërinë e faktit të kundërligjshëm të vërtetuar gjatë gjykimit, i cili, kur është gjykuar i rëndë ka konkluduar me masë të lartë dëmshpërblimi (75.000 Euro-Çështja Olldashi k. Bollino).

Në një rast gjykata ka marrë parasysh jo vetëm dëmin e shkaktuar paditësit por edhe gjendjen shoqërore, emotive dhe psikologjike të të paditurit, me qëllim vendosjen e një mase dëmshpërblimi të arsyeshme që diktohet nga kjo situatë (çështja Skeja, vëllai i njërit prej viktimave të ngjarjes së 21 janarit 2011).

Në shumicën e rasteve kur gjykata ka pranuar padinë dhe dhënien e një mase të caktuar dëmshpërblimi, ajo ka pranuar se dëmi jopasuror nuk matet me kriterë objektive por mbetet në anën e brendshme subjektive të të dëmtuarit për të vlerësuar nëse ka pasur apo jo dëm jopasuror si pasojë e faktit të paligjshëm. Gjykata kur ka pranuar ekzistencën e dëmit, ka vlerësuar p.sh se paditësi është person publik me reputacion të mirë dhe me deklaratat e të paditurit ndihet i cenuar. Gjykata ka konstatuar se në deklaratimet e të paditurit vihet re një sulm i drejtpërdrejt dhe personal ndaj paditësit nga ana e të paditurit pa patur asnjë të dhënë të provuar në këtë drejtim. Megjithatë gjykata ka çmuar se legjislacioni shqiptar lidhur me dëmshpërblimin ka efekt simbolik dhe synon të kompensojë të dëmtuarin me anë të vetë vendimit që jep gjykata, për këtë arsye, Gjykata vendos dëmshpërblimin në masën 700.000 lekë (ruli/tahiri), pa dhënë ndonjë shpjegim të mëtejshëm të raportit midis shkeljes, pasojës dhe masës së shpërblimit të dëmit të ardhur.

Në një rast, gjykata është ndalur më gjatë tek pasojat negative të ardhura nga thëniet e pavërteta duke vlerësuar se paditësi gëzon *reputacion pozitiv* dhe nga shkrimi i botuar ai është ndjerë i cenuar në personalitetin e tij, pasi kjo gjë ka rënduar *marrëdhëniet e tij familjare dhe për më tepër me fëmijët e mitur*. Këtu gjykata ka marrë parasysh edhe përfitimin ekonomik të nxjerrë nga i padituri nga thëniet e pavërteta, pasi ka shitur më shumë kopje duke theksuar lidhjen që ka bashkëshortja e paditësit me Enver Hoxhën. Megjithatë gjykata përsëri i është referuar efektit simbolik që ka dëmshpërblimi sipas legjislacionit shqiptar duke theksuar se forma kryesore e kompensimit për të dëmtuarin është vetë vendimi që jep gjykata, dhe për këtë shkak masa e dëmshpërblimit është shumë më e vogël se ajo e kërkuar (çështja Boga k. Republikës).

Në shumicën e rasteve, gjykata ka vlerësuar një masë simbolike të dëmshpërblimit, duke vlerësuar se shuma (1000.000 lekë)

është e arsyeshme duke mbajtur parasysh: rëndesën e akuzave, personalitetin social të paditësit, pozitën e të paditurit, mundësinë e këtij të fundit për të përgënjeshtruar thëniet, pagën e të paditurit (Malltezi). Megjithëse gjykata ka arritur në përfundimin se paditësit janë cenuar në dinjitetin e tyre, duke qenë se ata janë persona të respektuar në shoqëri për shkak të angazhimit të tyre profesional dhe se duke bërë publike thënie të pavërteta, atyre u është shkaktuar dëm i rëndë, gjykata ka çmuar se shuma prej 1000.000 lekë konsiderohet si shumë e arsyeshme duke mbajtur parasysh ciësitë e paditësve dhe të të paditurit, rëndesën e akuzave, personalitetin social të paditësit, pozitën e të paditurit, mënyrën e përhapjes së thënieve (nëpërmjet televizionit), mundësinë e të paditurit për të përgënjeshtruar thëniet, pagën e të paditurit (malltezi, bashkia tiranë, brecani).

Kur nga i dëmtuari është kërkuar përveç dëmshpërblimit edhe përgënjeshtrimi i thënieve, gjykatat në disa raste ka vlerësuar se modalitetet e përgënjeshtërimit duhet të përcaktohen nga paditësi, pasi nuk mund të caktojë gjykata mënyrën e ekzekutimit të tij. Në një rast tjetër, kjo kërkesë është pranuar nga gjykata duke detyruar të paditurin të bëjë përgënjeshtërimit e thënieve në të njëjtin organ dhe të njëjtën faqe e madhësi shkrimi ku është bërë artikulli fillestar. Ndoshta praktika duhet të konsolidohet në këtë drejtim.

TUCI K. SHOQËRIA STANDARD SHPK

Vendimi nr.6187, dt. 04.6.2013

Shkrimi i publikuar në gazetë nuk ka sjellë as pasoja negative (dëme) të menjëhershme për paditësin. I padituri nuk është përgjegjës për ndonjë pasojë pasi shkrimi nuk është hartuar nga punonjës të tyre. Rrëzimi i padisë.

Faktet

Në vitin 2007, në gazetën e botuar nga i padituri u botua një artikull me autor palën e tretë (H.LL) që akuzonte paditësin, me detyrë drejtor i drejtorisë arsimore së rrethit, për mungesë profesionalizmi dhe arsimit në përputhje me vendin e punës. Artikulli përmbante shprehje të tilla si: çoban, analfabet, sillet me mesuesit si me bagëtitë, i aftë për vjedhje e mashtrime punëson njerëzit kundrejt parave e jo aftësive etj.

Paditësi shpjegon para gjykatës se pas leximit të këtij artikulli ai është ndjerë i cenuar në nderin e tij, personalitetin dhe reputacionin e tij. Atij i janë shfaqur edhe turbullime të brendshme psikike, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi. Në kohën e botimit të artikullit ai ka qenë anëtar i këshillit bashkiak në Bashkinë Bulqizë dhe është larguar nga kjo detyrë si pasojë e efektit të këtij artikulli.

I padituri nuk pranon se i ka shkaktuar asnjë lloj dëmi paditësit sepse artikulli ka qenë thjesht një letër e hapur e lexuesve (popullit) në një rubrikë të posaçme që boton letrat e lexuesve. Paditësi gjithashtu nuk ka bërë asnjë kërkesë tek ne për përgënjeshtrim. Nuk qendron as pretendimi se ai është larguar nga detyra e anëtarit të këshillit bashkiak, ku ai jo vetëm ka vazhduar të ushtrojë detyrën por edhe është rizgjedhur në atë detyrë më pas.

Vlerësimi i Gjykatës

Paditësi nuk arrin të provojë pasojat e dëmshme që kanë ardhur nga ky shkrim as me ndonjë vlerësim mjekësor as me ndonjë provë tjetër. Edhe largimi i tij nga puna, siç pretendon, është bërë pas një periudhe 2 vjeçare dhe motivi i largimit nuk lidhet me efektin e shkrimit por me nevojat e përmirësimit të punës drejtuese. Madje ai është lënë në dispozicion të drejtorisë arsimore për t'u sistemuar në një detyrë tjetër. Ai gjithashtu ka ushtruar deri në vitin 2011 detyrën ai anëtar i këshillit bashkiak, gjë që provon se nuk i ka ardhur pasojë direkte nga shkrimi i botuar, siç ai pretendon.

Gjykata nuk arrin të gjej elementin e fajësisë në shkaktimin e dëmit, i cili po të provohet duhet të lidhet me elementin e fajit për të çuar në përgjegjësinë e shkaktuesit të dëmit. Pavarësisht se shkrimi është botuar në një gazetë që është organ i botuar nga i padituri, autor i shkrimit është personi i tretë (H.LL), i cili është botuar në rubrikën e opinionëve të lexuesve, pra autori nuk ka qenë i punësuar nga i padituri.

Gjykata arrin në përfundimin se paditësi nuk argumenton me prova dëmin e shkaktuar nga shkrimi i botuar dhe se i padituri nuk mban përgjegjësi pasi autori i shkrimit nuk është punonjës i tij por një lexues. Për këto arsye, padia rrëzohet.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit		X
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik		X
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

OLLDASHI K. BOLLINO, BASHA DHE MURATI

Vendimi nr.5694, dt. 23.05.2013

Organet e shtypit kanë detyrimin të paraqesin faktet në mënyrë të vërtetë e jo të disinformojnë opinionin publik ose ta shtrembërojnë jashtë çdo imagjinate, siç ka ndodhur në rastin konkret. Veprimet e kundërligjshme dhe me faj të të paditurve bazohen në faktin se ata kanë qenë tërësisht koshientë për dëmin që mund t'i shkaktonin paditësit nga ky veprim i kundërligjshëm. Pranim i padisë.

Faktet

Në nr.5231 të datës 24.03.2011 të periodikes Gazeta Shqiptare, konkretisht në faqen e parë të saj është anoncuar artikulli që mban titullin “*skandali, 460 kabina plazhi u jepen banorëve, vetëm 70 i merr Olldashi*”, ilustruar me fotografime me ngjyra të paditësit. Më tej, në brendësi të artikullit, jepen hollësira lidhur me një vendim të paditësit në detyrën e tij si Ministër i Punëve Publike, për të strehuar disa familje të pastreha dhe se si ai në kundërshtim me kriteret ligjore kishte përvetësuar direkt ose indirekt një pjesë të këtyre mjediseve.

Paditësi ka paraqitur para para gjykatës shkresën nr.872/6, me anë të së cilës, ai, në cilësinë e tij si Ministër i Punëve Publike, me datë 21.3.2011 i është drejtuar Këshillit të Ministrave duke propozuar projektvendimin për kalimin e disa objekteve nga administrimi i Ministrisë së Punëve Publike tek Enti Kombëtar i Banesave me qëllim strehimin e personave në nevojë. Kjo nismë është miratuar nga Këshilli i Ministrave me datë 23 mars 2011 dhe është bërë publike. Sipas vendimit, hapësirat shkojnë të gjitha në favor të personave të pastrehë. Si rrjedhojë, përmbajtja e artikullit të gazetës nuk përputhet me realitetin faktik.

Paditësi shpreh se pas leximit të këtij artikulli ai është ndjerë i cenuar në nderin e tij, personalitetin dhe reputacionin e tij me qëllim uljen e besueshmërisë së tij në prag të zgjedhjeve vendore

të atij viti. Gjithashtu, atij i janë shkaktuar edhe situata tensioni në aspektin personal dhe të marrëdhënieve me njerëzit e tij të afërt si dhe koleget e partisë politike ku ai aderon.

Të paditurit kërkuar rrëzimin e padisë për mungesë legjitimiteti, pasi Bollino pavarësisht se është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë Mediterranea, kërkesa për dëmshpërblim duhej të ngrhej ndaj personit juridik Mediterranea dhe jo ndaj përfaqësuesit të saj ligjor. Dy të paditurit (Basha dhe Murati) nuk morën pjesë në gjykim.

Vlerësimi i Gjykatës

Nga pikëpamja ligjore shkrimi në gazetë është një veprim i kundërligjshëm dhe është kryer me faj duke dëmtuar imazhin e paditësit duke cenuar nderin dhe personalitetin e tij si dhe një dëm në sferën shoqërore, gjë e cila sjell pas shpërblimit e dëmit ndaj paditësit. Ky shpërblim duhet të synojë kthimin e gjendjes së mëparshme të personit të dëmtuar. Gjithashtu, Gjykata ka parasysh edhe rrezikshmërinë e faktit të kundërligjshëm të vërtetuar gjatë gjykimit, i cili në rastin në gjykim çmohet si rëndë. Organet e shtypit kanë detyrimin të paraqesin faktet në mënyrë të vërtetë e jo të disinformojnë opinionin publik ose ta shtrembërojnë jashtë çdo imagjinate, siç ka ndodhur në rastin konkret.

Lidhur me mungesën e legjitimitetit të të paditurit Bollino, Gjykata vlerëson se së pari përgjegjësia është personale, pra e gazetarëve që kanë përgatitur lajmin. Më pas edhe punëdhënësi mban përgjegjësi për dëmin që shkakton i punësuarit prej tij, bazuar në nenin 619 dhe 620 të KC.

Për këto arsye, padia pranohet pjesërisht duke detyruar të paditurin Bollano të paguajë dëmshpërblim prej 75.000 Euro dhe detyrimin e dy të paditurve të tjerë Basha dhe Murati për të publikuar përgënjeshttrimin e paditësit në të njëjtën gazetë.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik		X
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme	X	
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

SHEHU K. XH. PEZA DHE SH. PEZA

Vendimi nr. 5311, dt. 14.05.2013

Fjalët dhe shprehjet e pretenduara nga paditësi si cennese në drejtim të nderit dhe personalitetit të tij përbëjnë veshjen apo parashtrimet e faktit të paligjshëm të pretenduar nga të paditurit në kallëzimin penal. Në këtë situatë, ndodhemi para faktit të formulimit të një akuze konkrete në drejtim të paditësit dhe depozitimit të një kallëzimi penal. Në përfundim të këtij procedimi palët mund të zgjidhin pasojat civile përkatëse. Rrëzimi i padisë.

Faktet

Të paditurit (bashkëshortë me njëri tjetrin) kanë depozituar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë kallëzimin penal me datë 31.07.2012 ndaj shtetasit I.Shehu (paditës). Në kallëzimin e paraqitur prej tyre, të paditurit kanë përdorur fjali të tilla kundrejt paditësit si *“biznesmen i fëlliqur nga paratë që posedon e përdor për realizimin e veprave penale dhe mënyra si i realizon ato...paraja e pisët e I.Shehut thyen çdo tabu dhe i duhet ti lutemi Zotit që veprimet e tij kriminale nuk do të drejtohen kundër jetës sonë...”*. Në hyrje të këtij kallëzimi është vendosur shprehja *“Për dijeni: kryetarit të komunës kashtar, Ministri i Brendshëm, Ministri i Drejtësisë, Prokurorja e Përgjithshme, Avokati i Popullit, Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe Presidenti i Republikës”*. Vepra penale për të cilën akuzohet paditësi është *“ndërtim i paligjshëm i një objekti në tokën e tjetrit”*, konkretisht toka në të cilën pretendohet se është ndërtuar pa leje është në pronësi të të paditurve Shehu.

Për këtë përmbajtje paditësi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar dëmshpërblim për fyerjet ndaj tij, pasi ai ndihet i fyer në personalitetin e tij nga përmbajtja e akuzës së ngritur nga të paditurit. Pavarësisht ecurisë së çështjes penale ndaj tij, i padituri kërkon gjykimin civil për shkak të fyerjes.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vëren se pala e paditur nuk rezulton të ketë kryer asnjë veprim të kundërligjshëm në dëm të interesave të ligjshme të palës paditëse. Fjalët dhe shprehjet e pretenduara nga paditësi si cënuesë në drejtim të nderit dhe personalitetit të tij përbëjnë veshjen apo parashtrimet e faktit të paligjshëm të pretenduar nga të paditurit në kallëzimin penal. Në këtë situatë, ndodhemi para faktit të formulimit të një akuze konkrete në drejtim të paditësit dhe depozitimit të një kallëzimi penal. Në përfundim të këtij procedimi palët mund të zgjidhin pasojat civile përkatëse.

Gjithashtu, Gjykata lidhur me bërjen publike të kallëzimit penal nga të paditurit, nuk konstaton asnjë provë apo fakt që ky kallëzim të jetë nisur në adresë të institucioneve të përmendura në krye të kallëzimit. Paditësi nuk arriti të provojë këtë fakt.

Për këto arsye, padia rrëzohet si e pambështetur në ligj dhe prova.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë		X
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit		X
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik		X
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje		X
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

BERISHA K. BALLA

Vendimi nr.5245, dt. 13.05.2013

Në dallim nga e drejta penale që bazohet në prezumimin e pafajësisë, e drejta e detyrimeve në lidhje me shkaktimin e dëmit bazohet në prezumimin e fajësisë duke pasur paditësi detyrimin për të provuar vetëm që deklaratimet e të paditurit i kanë cenuar nderin dhe personalitetin dhe barra e provës kalon tek i padituri për të provuar faktet që janë në themel të deklaratimeve të tij. I padituri nuk solli asnjë provë për të hedhur poshtë padinë për fyerje dhe shpifje. Pranimi i padisë.

Faktet

I padituri Balla, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, me datë 26.7.2012 dhe 19.2.2012 gjatë seancave parlamentare të transmetuara në median vizive ka deklaruar se përfaqësuesit e shoqërisë “Austrian Loteries” kanë fituar licensën për ushtrimin e aktivitetit në Shqipëri në marrëveshje me paditësin Shkëlzen Berisha, djali i Kryeministrit të Shqipërisë. Sipas Ballës, paditësi ka favorizuar shoqërinë e huaj “duke rënë dakort me Zenin...i cili nuk betohet nga prokuroria apo ILDKP për pasurinë që fiton brenda një viti, e cila është sa buxheti i katër bashkive të marra së bashku.”

Për këtë përmbajtje paditësi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar dëmshpërblim, pasi ai ndihet i fyer në personalitetin e tij nga përmbajtja e deklaratave që janë tërësisht të pavërteta. Ai kërkon dëmshpërblim në shumën prej 7.000.000 lekë dhe detyrimin e të paditurit të përgënjeshtrojë deklaratat e rreme.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata konstaton se thëniet e të paditurit janë të pambështetura në prova dhe përbëjnë fakte që cenojnë nderin dhe personalitetin e paditësit. I padituri nuk solli asnjë provë për të mbështetur thëniet e tij. Në dallim nga e drejta penale që bazohet në prezumimin e pafajësisë, e drejta e detyrimeve në

lidhje me shkaktimin e dëmit bazohet në prezumimin e fajësisë duke pasur paditësi detyrimin për të provuar vetëm që deklarimet e të paditurit i kanë cenuar nderin dhe personalitetin dhe barra e provës kalon tek i padituri për të provuar faktet që janë në themel të deklarimeve të tij.

Për këto arsye, padia rrëzohet si e pambështetur në ligj dhe prova.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë		X
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik		X
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

SKEJA K. DEDA

Vendimi nr.4651, dt. 29.04.2013

E drejta e personalitetit ka për objekt mënyrën e jetesës fizike apo morale të individit. Personaliteti i tij manifestohet në shoqërinë ku ai jeton dhe për rrjedhim është kjo e fundit që njeh dhe vlerëson vlerat e dinjitetit njerëzor. Në këtë kuptim cenimi i personalitetit dhe dinjitetit duke shkaktuar dhimbje të brendshme e vuajtje shpirtërore si individë dhe anëtarë i shoqërisë të shkaktohet nga vepra e paligjshme e të paditurit përbën cenim të të drejtave të personalitetit të mbrojtur nga Kushtetuta. Sa i takon masës së dëmshpërblimit, Gjykata vlerëson se ajo duhet të marrë në konsideratë cenimin e personalitetit dhe dinjitetit të paditësit si dhe të jetë i mundshëm për tu ekzekutuar si dhe edhe gjendjen shoqërore, e motive dhe psikologjike të të paditurit. Pranim i padisë.

Faktet

I padituri është vëllai i njërit prej viktimave të vrarë në datë 21 janar 2011 në Bulevardin Dëshmorët e Kombit, gjatë protestave të zhvilluara para Këshillit të Ministrave. Ai është prononcuar në media, konkretisht në televizionin Vizion Plus, ndër të tjera, se paditësi i kishte ofruar para në shkëmbim të informacionit në lidhje me vrasjen e vëllait të të paditurit, me qëllim që ky i fundit të pranonte vizitën e Kryeministrit. I padituri nuk ka pranuar dhe këtë fakt e ka bërë publik në media.

Paditësi ka kërkuar të përgënjeshtrohet informacioni prej të paditurit, por ky i fundit nuk ka pranuar dhe për këtë arsye paditësi është detyruar ti drejtohet gjykatës.

Për këtë përmbajtje paditësi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar dëmshpërblim, pasi ai ndihet i fyer në personalitetin e tij nga përmbajtja e deklaratave që janë tërësisht të pavërteta. Ai kërkon dëmshpërblim në shumën prej 2.000.000 lekë dhe detyrimin e të paditurit të përgënjeshtrojë deklaratat e reme.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata ka vlerësuar se liria e shprehjes garantohet nga Kushtetuta por deri në kufirin e paprekshmërisë së dinjitetit dhe personalitetit të individit. I padituri gjatë shprehjes duhet të respektonte disa parametra. Informacioni i dhënë prej tij duhej të ishte i vërtetë dhe autentik, që nënkupton përputhshmëri midis fakteve që kanë ndodhur dhe fakteve që tregohen, të ketë interes publik në atë që tregohet dhe korrektesë në transmetimin e fakteve me qëllim parandalimin e prekjës së dinjitetit dhe personalitetit të individit.

Pala e paditur ka deklaruar informacione për përfshirjen e paditësit në aktivitet të paligjshëm dhe që synonte fshehjen e autorit të vrasjes së vëllait të tij, përfshirjen dhe bashkëpunimin me autoritetin më të lartë të ekzekutivit në këto përpjekje etj. Deklarimet e të paditurit të ndërthurura me përhapjen e fakteve të rreme dhe të pasakta kanë cenuar dinjitetin dhe personalitetin e paditësit me përhapjen gjerësisht tek publiku i gjerë. Ato jo vetëm nuk i janë nënshtruar verifikimit për vërtetësinë e tij por me përhapjen nëpërmjet valëve televizive ka shkaktuar cenimin e vlerave të tilla që gezojnë mbrojtje kushtetuese për të cilat paditësi legjitimohet të kërkojë dëmshpërblim.

E drejta e personalitetit ka për objekt mënyrën e jetesës fizike apo morale të individit. Personaliteti i tij manifestohet në shoqërinë ku ai jeton dhe për rrjedhim është kjo e fundit që njeh dhe vlerëson vlerat e dinjitetit njerëzor. Në këtë kuptim cenimi i personalitetit dhe dinjitetit duke shkaktuar dhimbje të brendshme e vuajtje shpirtërore si individë dhe anëtarë i shoqërisë të shkaktuar nga vepra e paligjshme e të paditurit përbën cenim të të drejtave të personalitetit të mbrojtur nga Kushtetuta. Gjithashtu, vërtetohet edhe lidhja shkakësore midis fakti të paligjshëm pra cenimit të personalitetit dhe veprimeve të palës së paditurit. Sa i takon fajit, perderisa i padituri nuk arriti të provonte mungesën e tij, ai prezumohet.

Sa i takon masës së dëmshpërblimit, Gjykata vlerëson se ajo duhet të marrë në konsideratë cenimin e personalitetit dhe dinjitetit të paditësit si dhe të jetë i mundshëm për tu ekzeku-

tuar. Gjithashtu, gjykata merr parasysh edhe gjendjen shoqërore, e motive dhe psikologjike të të paditurit të cilit nga ngjarjet e 21 janarit 2011 i ishte vrarë i vëllai. Për këtë arsye, vendosi pranimin e padisë për shumën prej 99.999 lekë.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik		X
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme	X	
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit	X	

VELIAJ K. GOXHAJ

Vendimi nr.1502, dt. 18.02.2013

Cenimi i personalitetit dhe dinjitetit duke shkakutur dhimbje të brendshme e vuajtje shpirtërore si individë dhe anëtarë i shoqërisë të shkaktohet nga vepra e paligjshme e të paditurit përbën cenim të të drejtave të personalitetit të mbrojtur nga Kushtetuta. Sa i takon masës së dëmshpërblimit, Gjykata vlerëson se ajo duhet të marrë në konsideratë cenimin e personalitetit dhe dinjitetit të paditësit si dhe të jetë i mundshëm për tu ekzekutuar si dhe edhe gjendjen shoqërore, e motive dhe psikologjike të të paditurit. Dëmi ekzistencial nënkupton cenimin e vlerave komplekse të qenies njerëzore, të normalitetit dhe cilësisë së jetës së njeriut, të ndjenjave dhe të solidaritetit reciprok brenda familjes si dhe shprehjes së lirë e të plotë të aftësive të qenies njerëzore për të zhvilluar personalitetin për tu shfaqur në shoqëri në kuadër të njësisë bazë të saj: familjes. Paditësi duhet që pas publikimit apo transmetimit të informacionit të rremë dhe jo autentik të provonte përkeqësimin e cilësisë së jetës apo mënyrën e jetesës individuale.

Pranimi i padisë.

Faktet

I padituri në mënyrë periodike ka botuar në disa gazeta akuza të tilla se paditësi gjatë kohës kur drejtonte një grupim politik të quajtur “G99” dhe “Mjaft” ka përvetësuar vlera monetare të këtij grupimi, ka bërë evazion fiskal apo transferuar këto vlera nga njëra llogari në tjetrën në mënyrë të paligjshme. Konkretisht në gazetën Standard, datë 05.06.2009 i padituri ka shkruar artikullin “Veliaj dhe i vëllai, evazion fiskal me shifra qindra milionë lekë”. Në artikull thuhet: “Erion Veliaj zhduku bashkë me të vëllanë 300 mijë euro kredi për biznesin rinor. Më tej në gazetën Sot vazhdon: “Skandali, partia e Veliajt merr paratë e amerikaneve për të vëzhguar zgjedhjet e 28 qershorit”. Më tej në një emision televiziv në Vizion Plus është shprehur: “unë besoj se Erioni në historinë e viteve 2003-2009 për shumën 5.4

milionë euro të donatorëve që i ka siguruar nëpërmjet Mjaft ka bërë evazion fiskal.”

Për këtë përmbajtje paditësi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar dëmshpërblim, pasi ai ndihet i fyer në personalitetin e tij nga përmbajtja e deklaratave që janë tërësisht të pavërteta. Ai kërkon dëmshpërblim në shumën prej 10 mijë euro.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata ka vlerësuar se liria e shprehjes garantohet nga Kushtetuta por deri në kufirin e paprekshmërisë së dinjitetit dhe personalitetit të individit. I padituri gjatë shprehjes duhet të respektonte disa parametra. Informacioni i dhënë prej tij duhej të ishte i vërtetë dhe autentik, që nënkupton përputhshmëri midis fakteve që kanë ndodhur dhe fakteve që tregohen, të ketë interes publik në atë që tregohet dhe korrektesë në transmetimin e fakteve me qëllim parandalimin e prekjës së dinjitetit dhe personalitetit të individit.

Pala e paditur ka deklaruar informacione për përfshirjen e paditësit në përvetësimin e vlerave monetare të disa grupeve politike gjatë kohës kur ai drejtonte këto grupe apo ka konsumuar veprën penale të evazionit fiskal. Kjo e fundit është bërë dhe objekt hetimi nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin e datës 30 qershor 2010 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr.3379, viti 2009 për veprën penale të mospagimit të taksave dhe tatimeve, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Deklarimet e të paditurit të ndërthurura me përhapjen e fakteve të rreme dhe të pasakta kanë cenuar dinjitetin dhe personalitetin e paditësit me përhapjen gjerësisht tek publiku i gjerë. Ato jo vetëm nuk i janë nënshtruar verifikimit për vërtetësinë e tij por me përhapjen nëpërmjet valëve televizive ka shkaktuar cenimin e vlerave të tilla që gezojnë mbrojtje kushtetuese për të cilat paditësi legjitimohet të kërkojë dëmshpërblim.

E drejta e personalitetit ka për objekt mënyrën e jetesës fizike apo morale të individit. Personaliteti i tij manifestohet në shoqërinë ku ai jeton dhe për rrjedhim është kjo e fundit që një

dhe vlerëson vlerat e dinjitetit njerëzor. Në këtë kuptim cenimi i personalitetit dhe dinjitetit duke shkakuar dhimbje të brendshme e vuajtje shpirtërore si individë dhe anëtarë i shoqërisë të shkaktoar nga vepra e paligjshme e të paditurit përbën cenim të drejtave të personalitetit të mbrojtur nga Kushtetuta. Gjithashtu, vërtetohet edhe lidhja shkakësore midis fakti të paligjshëm pra cenimit të personalitetit dhe veprimeve të palës së paditurit. Sa i takon fajit, perderisa i padituri nuk arriti të provonte mungesën e tij, ai prezumohet.

Sa i takon masës së dëmshpërblimit, Gjykata vlerëson se ajo duhet të marrë në konsideratë cenimin e personalitetit dhe dinjitetit të paditësit si dhe të jetë i mundshëm për tu ekzekutuar. Gjithashtu, gjykata vlerëson se nuk mund të pranohet kërkitimi për dëmshpërblimin në monedhën euro pasi dëmi ka ndodhur në Shqipëri dhe duhet të akordohet në monedhën vendase. Në lidhje me komponentin e dëmit jopasuror, gjykata e gjen të pabazuar këtë kërkim. Dëmi ekzistencial përfaqëson komponentë të dëmit jopasuror i ndryshëm nga dëmi biologjik dhe që përcaktohet në ndryshimin e detyruar të cilësisë së jetës dhe mënyrës së vepruarit. Dëmi ekzistencial nënkupton cenimin e vlerave komplekse të qenies njerëzore, të normalitetit dhe cilësisë së jetës së njeriut, të ndjenjave dhe të solidaritetit reciprok brenda familjes si dhe shprehjes së lirë e të plotë të aftësive të qenies njerëzore për të zhvilluar personalitetin për tu shfaqur në shoqëri në kuadër të njësisë bazë të saj: familjes. Paditësi duhej që pas publikimit apo transmetimit të informacionit të rremë dhe jo autentik të provonte përkeqësimin e cilësisë së jetës apo mënyrën e jetesës individuale.

Për këto arsye, padia pranohet pjesërisht si e bazuar.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

POLLO K. BALLA

Vendimi nr.4424, dt. 13.02.2012

Nderi dhe personaliteti i një individ është masa e vlerësimit që shoqëria krijon për individin ose personin publik. Ky vlerësim krijohet nga vetëqendrimet dhe veprimtaria që shfaq individi në publik. Nderi dhe personaliteti pozitiv krijohen kur veprimtaria e individit bazohet në sjellje të moralshme dhe respektimit të individëve të tjerë. T'i atribuosh individit sjellje të paqena dhe që krijojnë një opinion negativ përbën cenim të nderit dhe personalitetit. Sa i takon masës së dëmshpërblimit, Gjykata vlerëson se shpërblimi ka më së shumti efekt ndëshkues dhe jo efekt rimbursues për paditësin. Efektin rimbursues për paditësin e luan vetë ky vendim gjyqësor i cili njeht padrejtësinë dhe pavartetësinë e këtyre thënieve. Pranim i padisë.

Faktet

Të dy palët janë deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. Në datë 20.10.2011 në Kuvendin e Shqipërisë me kërkesë të të paditurit Balla është zhvilluar interprelamcë me Ministrin për Inovacion dhe Teknologji, paditësi Pollo. Në fjalën e të paditurit ngrihen akuza ndaj paditësit Pollo për abuzim me detyrën dhe marrjen e një ryshfeti prej 1.2 milionë Euro. Rezulton se kjo deklaratë e të paditurit është transmetuar në disa media vizive si Top Channel, Ora News, News 24 Vizion Plus. Po ashtu fjala e tij është botuar në shtypin e shkruar si Panorama Shekulli etj.

Menjëherë pas deklaratave në Kuvend ILDKP ka nisur një procedim hetimor administrativ ndaj paditësit. Në përfundim nuk ka rezultuar asnjë shkelje ligjore apo konflikt interesi në ushtrimin e detyrës së paditësit. Gjithashtu, edhe pas kallëzimit penal të bërë nga i padituri në drejtim të paditësit, prokuroria ka vendosur pushimin e procedimit penal. Vendimi i prokurorisë nuk është ankimuar nga i padituri.

Paditësi pretendon se nga fjalimi i të paditurit pshtë ndjerë i fyer në personalitetin e tij nga përmbajtja e deklaratave që janë

tërësisht të pavërteta. Ai kërkon dëmshpërblim në shumën prej 1.000.000 lekë.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata ka vlerësuar se fjala e të paditurit në interpelancë nga mënyra se si i është ofruar publikut përbën veprim të kundërligjshëm dhe të kryer me faj, veprim i cili ka dëmtuar imazhin e paditësit duke i shkaktuar atij dëm konkret moral të shfaqur në drejtim të dëmtimit të nderi dhe personalitetit të tij si dhe dëm në sferën shoqërore, gjë e cila sjell përgjegjësi civile për të paditurin për shpërblimin e këtij dëmi.

Gjykata konstaton se i padituri ka konsumuar 4 elementët e kësaj përgjegjësie: kundërligjshmërinë e veprimeve të shkaktuesit të dëmit, dëmi i shkaktuar, fajësia dhe lidhja shkakësore. Nderi dhe personaliteti i një individ është masa e vlerësimit që shoqëria krijon për individin ose personin publik. Ky vlerësim krijohet nga vetëqendrimet dhe veprimtaria që shfaq individ në publik. Nderi dhe personaliteti pozitiv krijohen kur veprimtaria e individit bazohet në sjellje të moralshme dhe respektimit të individëve të tjerë. Ti atribuosh individit sjellje të paqena dhe që krijojnë një opinion negativ përbën cenim të nderit dhe personalitetit në kuptim të nenit 625 të Kodit Civil.

Sa i takon masës së dëmshpërblimit, Gjykata vlerëson se ajo duhet të marrë në konsideratë cilësitë e personit të dëmtuar dhe shkaktuesit të dëmit, mënyrën e shkaktimit të dëmit dhe mjeti i përdorur, rrezikshmërinë e faktit të kundërligjshëm, formën e fajit. Shpërblimi ka më së shumti efekt ndëshkues dhe jo efekt rimbursues për paditësin. Efektin rimbursues për paditësin e luan vetë ky vendim gjyqësor i cili njeh padrejtësinë dhe pavërtetësinë e këtyre thënieve. Për këto arsye, padia pranohet pjesërisht si e bazuar.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

KOKËDHIMA K. OLLDASHI

Vendimi nr.1628, dt. 4.3.2011

Bërja publike e lidhjeve të një personi që administron shoqëri tregtare që kryejnë punime publike nga përfitimet me tendera të organizuara nga Bashkia apo institucione të tjera nuk përbën cenim të reputacionit apo moralit por është detyrim i përfaqësuesve të popullit për të informuar zgjedhësit e tyre. Rrëzim i padisë.

Faktet

I padituri, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në seancën parlamentare të datës 3.11.2008 ka deklaruar se *“shqiptarët kanë nevojë për përgjigje se si është e mundur që Koço Kokëdhima fiton katës tendera për një ditë në bashki, si privatizoi me 2 lekë frigoriferin e Fierit zoti Kokëdhima... Rama di të krijojë vetëm familje mafioze si Beso, Dulaku dhe Kokëdhima”*.

Paditësi pretendon se nga fjalimi i të paditurit pshtë ndjerë i fyer në personalitetin e tij nga përmbajtja e deklaratave që janë tërësisht të pavërteta. Ai është cenuar gjithashtu edhe në aktivitetin e tij si sipërmarrës dhe kërkon dëmshpërblim në shumën prej 1.00.000 lekë.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata ka vlerësuar se fjala e të paditurit megjithë shprehjet konkrete është mbajtur në ushtrim të funksionit të të paditurit si deputet i Kuvendit. Fjalimi i tij nuk i është drejtuar konkretisht paditësit por opozitës, pjesë e të cilit nuk është paditësi. Ai ka për detyrë të informojë publikun sesi kundërshtari i tij politik e ushtron detyrën e tij. Pra, shprehjet e tij i janë drejtuar kryetarit të partisë opozitare dhe të bashkisë njeherazi dhe jo paditësit.

Bërja publike e lidhjeve të një personi që administron shoqëri tregtare që kryejnë punime publike nga përfitimet me tendera të organizuara nga Bashkia apo institucione të tjera nuk përbën

cenim të reputacionit apo moralit por është detyrim i përfaqësuesve të popullit për të informuar zgjedhësit e tyre. Pyetja “si ka mundësi që Kokëdhima fiton 4 tendera në dite” nuk i drejtohet paditësit por opozitës pra nuk lidhet drejtpërdrejt me paditësin dhe nuk mund të cenojë personalitetin e tij.

Gjykata konstaton gjithashtu se edhe çështja e privatizimit të frigoriferit “për dy lekë” është shprehje hiperbolike për të thënë se është privatizuar me çmim shumë më të ulët se e tregut. Ky fakt është i provuar me shkresat e sjella nga i padituri. Një gjë të tillë, gjykata nuk e konsideron fyerje pasi fakti provohet.

Gjykata vlerëson se i padituri nuk rezulton të ketë konsumuar 4 elementët e kësaj përgjegjësie: kundërligjshmërinë e veprimeve të shkaktuesit të dëmit, dëmi i shkaktuar, fajësia dhe lidhja shkakësore. Për këtë arsye, padia rrëzohet si e pabazuar.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme	X	
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

SHOQËRIA “FERAR” K. VALIKAJ (FELAJ)

Vendimi nr.4291, dt. 24.5.2011

Funksioni dhe detyra e deputetit lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë gjithmonë dhe pa kufizim mbrojtje nga neni 73 i Kushtetutës. Edhe personit juridik ashtu si atij fizik mund t'i shkaktobet dëm jopasuror, i cili mund të cenojë emrin e mirë dhe reputacionin e personit juridik i cili është i denjë për tu mbrojtur nga rendi juridik. Pranim i padisë.

Faktet

I padituri, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në konferencën për shtyp të datës 11.1.2011 ka deklaruar se “shoqëria italiane Radiç është skualifikuar pa të drejtë nga procedura e dhënies me koncesion të hidrocentralit mbi lumin Bënçë, pasi në garë ka hyrë shoqëria “Ferar”-shpk e afërt me Ministrin e Ekonomisë Z.Genc Ruli. Pas shoqërisë Ferar qëndron bashkëshorti i deputetes rajmonda Bulku.”

Paditësi pretendon se nga deklaratat e të paditurit i është shkaktuar dëm jopasuror duke njollosur publikisht emrin dhe personalitetin e kësaj shoqërie. Deklaratat është e rreme dhe ka cenuar gjithashtu edhe aktivitetin e tij si sipërmarrës dhe kërkon dëmshpërblim në shumën prej 2000.000 lekë.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se i padituri është një subjekt që ka një mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta lidhur me lirinë e shprehjes (neni 73 i Kushtetutës). Funksioni dhe detyra e deputetit lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë mbrojtje nga neni 73 i Kushtetutës, pasi: së pari deklaratat nuk janë bërë në ambjentet e Kuvendit ose të tjera të barazuara me të. Ato nuk ishin as riprodhim i deklaratave të bërë gjatë punimeve të Kuvendit. Së dyti, nuk është në misionin e deputetit të bëjë akuza publike për fakte

konkrete. Ai mund ti denoncojë në organet e prokurorisë pasi të ketë bërë kallëzim sipas rregullave procedurale. Së treti, pohimet e palës së paditur nuk u provuan të ishin të vërteta. Paditësi paraqiti prova për të mbështetur pretendimet e saj për zbatimin me korrektësi të procedurave të tenderimit me qëllim marrjen me koncesion të hidrocentralit.

Gjykata vlerëson se edhe personit juridik ashtu si atij fizik mund t'i shkaktohet dëm jopasuror, i cili mund të cenojë emrin e mirë dhe reputacionin e personit juridik i cili është i denjë për tu mbrojtur nga rendi juridik, sipas nenit 625/a e Kodit Civil. Dëmi jopasuror nuk matet me kriterë objektive por mbetet në anën e brendshme subjektive të të dëmtuarit për të vlerësuar nëse ka pasur apo jo dëm jopasuror si pasojë e faktit të paligjshëm. Gjykata pranon ekzistencën e dëmit, pasi paditësi është shoqëri me reputacion të mirë në fushën e ndërtimeve dhe me deklaratat e të paditurës ndihet i cenuar. Gjykata, gjithashtu provon dhe lidhjen shkakësore dhe fajin e të paditurës në shkaktimin e dëmit.

I padituri rezulton të ketë konsumuar 4 elementët e kësaj përgjegjësie: kundërligjshmërinë e veprimeve të shkaktuesit të dëmit, dëmi i shkaktuar, fajësia dhe lidhja shkakësore. Për këtë arsye, padia pranohet pjesërisht.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit	X	

RULI K. TAHIRIT

Vendimi nr.1468, dt. 18.2.2013

Funksioni dhe detyra e deputetit lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë gjithmonë dhe pa kufizim mbrojtje nga neni 73 i Kushtetutës. Nuk është në detyrën dhe funksionin e deputetit të bëjë akuza publike për fakte konkrete. Ai mund ti denoncojë në organet e prokurorisë pasi të ketë bërë kallëzim sipas rregullave procedurale. Pranim i padisë.

Faktet

Të dyja palët janë deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. I paditurinë seancën parlamentare të datës 13 shtator 2011 ka bërë deklaratat të rreme kundrejt paditësit duke i cenuar këtij të fundit reputacionin dhe deklaruar se “shoqëria italiane Radiç është skualifikuar pa të drejtë nga procedura e dhënies me koncesion të hidrocentralit mbi lumin Bënçë, pasi në garë ka hyrë shoqëria “Ferar”shpk e afërt me Ministrin e Ekonomisë Z.Genc Ruli. Pas shoqërisë Ferar qëndron bashkëshorti i deputetes Rajmonda Bulku”(i afërm i paditësit).

Paditësi pretendon se nga deklaratat e të paditurit i është shkaktuar dëm jopasuror duke njollosur publikisht emrin dhe personalitetin e tij si person publik. Deklarata është e rreme dhe ka cenuar gjithashtu edhe aktivitetin e tij si politikan por dhe si qytetar dhe kërkon dëmshpërblim në shumën prej 5.000.000 lekë.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se i padituri është një subjekt që ka një mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta lidhur me lirinë e shprehjes (neni 73 i Kushtetutës). Funksioni dhe detyra e deputetit lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë mbrojtje nga neni 73 i Kushtetutës, pasi: nuk është në misionin e depute-

tit të bëjë akuza publike për fakte konkrete. Ai mund ti denoncojë në organet e prokurorisë pasi të ketë bërë kallëzim sipas rregullave procedurale. Gjithashtu, pohimet e palës së paditur nuk u provuan të ishin të vërteta. Paditësi paraqiti prova për të mbështetur pretendimet e saj për zbatimin me korrektësi të procedurave të tenderimit me qëllim marrjen me koncesion të hidrocentralit.

Lidhur me dëmin jopasuror Gjykata vlerëson se deklaratat e rreme mund të cenojnë emrin e mirë nderin dhe reputacionin e njeriut, të cilat janë të denja për tu mbrojtur nga rendi juridik, sipas nenit 625/a të Kodit Civil. Dëmi jopasuror nuk matet me kriterë objektive por mbetet në anën e brendshme subjektive të të dëmtuarit për të vlerësuar nëse ka pasur apo jo dëm jopasuror si pasojë e faktit të paligjshëm. Gjykata pranon ekzistencën e dëmit, pasi paditësi është person publik me reputacion të mirë dhe me deklaratat e të paditurit ndihet i cenuar. I padituri ka aluduar se paditësi është bashkëpronar i shoqërisë që ka përfutur koncesionin dhe ka patur përfitime të drejtpërdrejta prej tij. Gjykata çmon se në deklaratimet e të paditurit vihet re një sulm i drejtpërdrejt dhe personal ndaj paditësit nga ana e të paditurit pa patur asnjë të dhënë të provuar në këtë drejtim. Gjykata, gjithashtu, provon dhe lidhjen shkakësore dhe fajin e të paditurit në shkaktimin e dëmit.

I padituri rezulton të ketë konsumuar 4 elementët e kësaj përgjegjësie: kundërligjshmërinë e veprimeve të shkaktuesit të dëmit, dëmi i shkaktuar, fajësia dhe lidhja shkakësore. Për këtë arsye, padia pranohet pjesërisht. Nisur nga fakti se legjislacioni shqiptar lidhur me dëmshpërblimin ka efekt simbolik dhe synon të kompensojë të dëmtuarin me anë të vendimit që jep gjykata, për këtë arsye, Gjykata vendos dëmshpërblimin në masën 700.000 lekë.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve	X	
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit	X	

BOGA K. PANORAMA GROUP, RAKIPLLARI

Vendimi nr.12571, dt. 16.12.2013

Gazetari dhe media kanë detyrën për të informuar publikun për fakte me interes për të pa u shkaktuar dëm të tjerëve dhe pa thënë gjëra të pavërteta ose të pabazuara në fakte. Një sjellje e tillë nga personi që shkruan thënie të pabaza dhe cennese do të thotë të bësh atë që njeriu i arsyeshëm nuk do ta kishte bërë ose të mos bësh atë që njeriu i arsyeshëm do të kishte bërë. Njeriu me arsye mesatare nuk parashton fakte të pabaza në drejtim të askujt. E drejta për të informuar publikun mbaron aty ku fillon e drejta e tjetrit që të mos i cenohet në mënyrë të paligjshme nderi personaliteti dhe reputacioni e jeta private nga shprehje fyese dhe të pavërteta. Pranim i padisë.

Faktet

Paditësi është i martuar me V.H dhe kanë dy fëmijë te mitur I. dhe K. Në gazetën Panorama të datës 9 qershor 2013, botues i të cilës është i padituri, është botuar një foto e bashkëshortes dhe dy fëmijëve të paditësit me komentin: “V.H të bashkëjetesën, ikën me dy fëmijët në Vjenë... atyre nuk u bashkohet G.Boga (paditësi) ... burimet tregojnë se bashkëjetesa mes tyre nuk është si më parë dhe një ndarje e mundshme flitet prej kohësh. Shtojmë se çifti nuk ka qenë asnjëherë i martuar zyrtarisht sado që prej gati 15 vjetesh kanë pasur historinë e tyre të dashurisë a bashkëjetesës.”

Paditësi pretendon se nga shkrimi në gazetë aludohet për një ndarje të mundshme të paditësit dhe bashkëshortes së tij duke paraqitur si shkak mospasjen e martesës zyrtare, gjë të cilën paditësi e konsideron si të pavërtetë duke paraqitur edhe certifikatën e martesës që vërteton lidhjen e martesës në vitin 2003. Paditësi pretendon se në artikullin në fjalë janë përhapur thënie të rreme në lidhje me martesën e paditësit, të cilat kanë kanë cenuar dinjitetin dhe personalitetin e tij. Shpifjet e paditësit rëndojnë mbi martesën dhe familjen e tij duke tronditur edhe fëmijët e tij të cilët mund të krijojnë përfytyrime të pavërteta

karshi prindërve të tyre. Një gjë e tillë prish atmosferën familjare. Padiësi kërkon dëmshpërblim në shumën prej 2.000.000 lekë dhe detyrimin për të përgënjeshtuar përmbajtjen e artikullit.

I padituri prapësoi se pala paditëse nuk arriti të provonte dëmin që i ishte shkaktuar në sferën emocionale të tij. Shkrimi i botuar nuk sjell dëmtim të personalitetit pasi mosqenia i martuar nuk është shkak për tu ndjerë i fyer. Shkrimi nuk ka thënie dashakeqe. I padituri Rakiplari kërkoi rrëzimin e padisë pasi ai është i punësuar nga i padituri Panorama group dhe nuk legjitimohet në marrjen e përgjegjësisë për dëmshpërblim.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se nderi, reputacioni dhe personaliteti gjen mbrojtje të veçantë nga legjislacioni shqiptar. Gjykata duke analizuar 4 elementët për konstatimin e dëmit jopasuror (sjellja e paligjishme, dëmi i shkaktuar, lidhja shkakësore dhe faji) vlerëson se ato plotësohen. Së pari, sjellja e paligjishme konsiston në përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve që cenon nderin dhe personalitetin e padiësit. Shkrimi përmban fakte të pavërteta rreth bashkëjetesës/martësës së tij dhe bashkëshortes. Gazetari dhe media kanë detyrën për të informuar publikun për fakte me interes për të pa u shkaktuar dëm të tjereëve dhe pa thënë gjëra të pavërteta ose të pabazuara në fakte. Një sjellje e tillë nga personi që shkruan thënie të pabaza dhe cenuese do të thotë të bësh atë që njeriu i arsyeshëm nuk do ta kishte bërë ose të mos bësh atë që njeriu i arsyeshëm do të kishte bërë. Njeriu me arsye mesatare nuk parashtron fakte të pabaza në drejtim të askujt. E drejta për të informuar publikun mbaron aty ku fillon e drejta e tjetrit që të mos i cenohet në mënyrë të paligjishme nderi personaliteti dhe reputacioni e jeta private nga shprehje fyese dhe të pavërteta. Rezultoi e provuar se shkrimi ishte shpifës dhe i pavërtetë duke aluduar si shkak i prishjes së marrëdhënies midis padiësit dhe bashkëshortes së tij ishte mospasja e një martese ligjore. Kjo e ka vënë padiësin në pozitë negative në sytë e publikut duke krijuar perceptime të pabaza për jetën e tij familjare. Liria e shprehjes dhe ajo e informimit kufizohet nga ligjshmëria.

Paditësi gëzon reputacion pozitiv dhe nga shkrimi i botuar ai është ndjerë i cenuar në personalitetin e tij, pasi kjo gjë ka rënduar marrëdhëniet e tij familjare dhe për më tepër me fëmijët e mitur. Lidhja shkakësore midis dëmit të shkaktuar dhe përdorimit të fjalëve e shprehjeve të pavërteta provohet gjithashtu. Edhe faji, si element i fundit provohet në formën e pakujdesisë së rëndë për shkak se pala e paditur duhet të kishte marrë masat për mospërdorim të thënieve të pavërteta. I padituri nëpërmjet veprimit të paligjshëm ka nxjerrë edhe përfitime pasi ka shitur më shumë kopje duke theksuar lidhjen që ka bashkëshortja e paditësit me Enver Hoxhën.

I padituri rezulton të ketë konsumuar 4 elementët e kësaj përgjegjësie: kundërligjshmërinë e veprimeve të shkaktuesit të dëmit, dëmi i shkaktuar, fajësia dhe lidhja shkakësore. Për këtë arsye, padia pranohet pjesërisht. Nisur nga fakti se legjislacioni shqiptar lidhur me dëmshpërblimin ka efekt simbolik dhe synon të kompensojë të dëmtuarin me anë të vendimit që jep gjykata, për këtë arsye, Gjykata vendos dëmshpërblimin në masën 2.00.000 lekë. Nuk u paraqit asnjë provë që i padituri të mos ketë mundësi financiare për të paguar dëmshpërblimin. Lidhur me detyrimin për përgënjeshttrim të shkrimit, Gjykata vlerëson se modalitetet e përgënjeshttrimit duhet të përcaktohen nga paditësi, pasi nuk mund të caktojë gjykata mënyrën e tij.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve	X	
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi	X	
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit	X	

MARKU K. KASO, GAZETA REPUBLIKA

Vendimi nr.8654, dt. 23.7.2013

Historia komuniste e Shqipërisë dubet të rishkrubet dhe zhvishet nga ideologjia. Në shkrimin e tij i padituri nuk është në rolin e historianit dhe as ka qenë prezent në ngjarjet për të cilat flet. Ai ka dhënë konsiderata bazuar në thëniet e dëguara nga të tretë. E drejta e personalitetit ka për objekt mënyrën e jetesës, fizike apo morale të individit. Personaliteti i tij manifestohet në shoqërinë ku ai jeton dhe për rrjedhim është kjo e fundit që njeh dhe vlerëson vlerat e dinjitetit njerëzor. Pranim i padisë.

Faktet

Paditësja është e bija e Gj.M, personazh i cili është përmendur në një shkrim në gazetën Republika të titulluar “Ditët që tronditën Mirditën”. Ky shkrim ka për autor të paditurin, i cili evokon një periudhë kohore gjatë diktaturës komuniste, gjatë të cilës zona e Mirditës pësoi një trajtim çnjerëzor nga forcat e armatosura për shkak të kryengritjes antikomuniste. Midis të tjerave shprehet se: “...dy nga personazhet më famëkeq janë gjeneralët e kuq M.Sh dhe Gj.M (i ati i paditëses). Ai pasi bëri një jetë qefesh të shfrenuara, sidomos me femrat, u burgos nga idhulli i tij Enver Hoxha. Ai vdiq në burg, të dy djemtë e tij u burgosën, e shoqja dhe të bijat u internuan. Në vitin 1993 Presidenti i dekoroi Gj.M me urdherin “Për veprimtari patriotike të klasit të parë”.

Paditësja pretendon se këto pjesë të shkrimit përbëjnë fyerje flagrante dhe fyese në kujtim të babait të saj të ndjerë. Ajo i ka kërkuar disa herë gazetës ta përgenjështrojë lajmin, po ajo ka refuzuar duke i thënë të botojë variantin e saj të historisë.

I padituri pretendoi se faktet e thëna prej tij ishin të treguara nga dëshmitarë okularë, të cilët ai refuzoi t'i identifikonte para Gjykatës, megjithë insistimin e kësaj të fundit.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se autori evokon një periudhë kohore të komunizmit, e cila është ende mjaft problematike sa i takon shkrimit të historisë së asaj periudhe. Historia komuniste e Shqipërisë duhet të rishkruhet dhe zhvishet nga ideologjia. Në shkrimin e tij i padituri nuk është në rolin e historianit dhe as ka qenë prezent në ngjarjet për të cilat flet. Ai ka dhënë konsiderata bazuar në thëniet e dëguara nga të tretë. Ai nuk paraqiti në gjykim prova ku të mbështesë vërtetësinë e thënieve të tij.

I padituri duhej të respektonte disa parametra lidhur me informacionin që jep, ai duhet të jetë autentik, i vërtetë dhe në përputhje me faktet që kanë ndodhur, të ketë interes publik në atë që tregohet si dhe korrektësi në botimin dhe transmetimin e fakteve me qëllim moscenimin e nderit dhe dinjitetit të individit. Në shkrimin konkret, i padituri ka treguar ngjarje që janë të pavërteta rreth babait të paditëses. Në këtë mënyrë, është cenuar nderi, reputacioni dhe personaliteti i tij. Gjykata duke analizuar 4 elementët për konstatimin e dëmit jopasuror (sjellja e paligjshme, dëmi i shkaktuar, lidhja shkakësore dhe faji) vlerëson se ato plotësohen. Së pari, sjellja e paligjshme konsiston në përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve që cenon nderin dhe personalitetin e babit të paditëses. E drejta e personalitetit ka për objekt mënyrën e jetesës, fizike apo morale të individit. Personaliteti i tij manifestohet në shoqërinë ku ai jeton dhe për rrjedhim është kjo e fundit që njeh dhe vlerëson vlerat e dinjitetit njerëzor.

I padituri rezulton të ketë konsumuar 4 elementët e kësaj përgjegjësie: kundërligjshmërinë e veprimeve të shkaktuesit të dëmit, dëmi i shkaktuar, fajësia dhe lidhja shkakësore. Për këtë arsye, padia pranohet pjesërisht. Nisur nga fakti se legjislacioni shqiptar lidhur me dëmshpërblimin ka efekt simbolik dhe synon të kompensojë të dëmtuarin me anë të vendimit që jep gjykata, për këtë arsye, Gjykata vendos dëmshpërblimin në masën 500.000 lekë, pasi lajmi është përhapur me shpejtësi për shkak të tirazhit jo të vogël të gazetës dhe për shkak se nuk është pranuar përgenjshtrimi nga i padituri (gazeta republika).

Nuk u paraqit asnjë provë që i padituri të mos ketë mundësi financiare për të paguar dëmshpërblimin. Lidhur me detyrimin për përgenjështim të shkrimit, Gjykata vlerëson se kërkesa duhet pranuar, duke detyruar gazetën Republika të botojë atë në të njëjtën formë dhe mënyrë me publikimin e shkrimit dhe transmetimit të informacionit të rremë të botuar prej saj.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve	X	
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë	X	
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme	X	
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje		X
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit	X	

KULIÇAJ K. TAHIRI

Vendimi nr.9804, dt. 2.10.2013

Shprehja e përdorur dhe e konsideruar si shpifje dhe fyerje për paditësin është një pjesë e deklaratës së bërë nga i padituri në ushtrimin e funksionit të tij si politikan dhe opozitar për t'i sqaruar popullit t tij me informacione dhe opinione të veta shkaqet që, sipas tij, kanë sjellë situata të rënda sociale dhe problematike për një pjesë të caktuar të shoqërisë shqiptare. Rrëzim i padisë.

Faktet

Paditësi në detyrën Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të policisë së shtetit. I padituri është deputet në Kuvendin e Shqipërisë. I padituri nga foltorja e Kuvendit në seancën e datës 13 shtator 2011, gjatë interpelancës me Ministrin e Ekonomisë për problemin e licensave minerare, midis të tjerave është shprehur: "...kontrabanda shkon dhe më lart, të paprekshmit e familjes Berisha. Emri i Agron Kuliçajt lidhet drejtpërdrejt me kontrabandën e minierave."

Paditësi pretendon se këto deklarata janë tërësisht të pavërteta dhe përbëjnë fyerje kundrejt tij duke cenuar nderin dhe dinjitetin e tij. Ai kërkon dëmshpërblim moral dhe përgënjeshttrim të tyre nga i padituri.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata administroi prova (CD që përmban regjistrimin e deklaratave të të paditurit). U provua se CD e sjellë nuk ka ndërhyrje në formë montimi të deklaratave të bëra nga i padituri. Gjithashtu, u administruan edhe kopje të mediave të shkruara të publikuara në Balkanweb, albania Observer e datës 14 shtator 2011. Pra provohen deklaratat e bëra nga i padituri në drejtim të paditësit. Gjykata vlerëson 4 elementët e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar paditësit. Kundërligjshmëria e veprimeve

të të paditurit nuk provohet, pasi ai nuk ka patur qëllim fyerjen e paditësit por evidentimin e fakteve korruptive në ushtrim të detyrës së tij si deputet. Lidhur me fajësinë, ajo konstaton se i padituri në rolin e tij si deputet i Kuvendit të Shqipërisë gjatë bërjes së deklaratave të mësipërme ka qenë në ushtrim të funksionit të tij si deputet duke denoncuar fakte korruptive. Këtë gjykata e bazon edhe në praktikën e GJL (vendimi nr/7/2011), e cila është shprehur se: “deklaratat e sipërcituara janë bërë nga një deputete e Kuvendit, në ushtrim të funksionit të saj si përfaqësuese e popullit”. Pra qëllimi i të paditurit nuk ka qenë dëmtimi i nderi dhe dinjitetit të paditësit por denoncimi i fakteve korruptive. Për këtë arsye, mungon elementi i fajit. Gjithashtu, paditësi nuk solli fakte se çfarë dëmi i është shkaktuar nga deklaratat e të paditurit

Për këto arsye, padia rrëzohet si pabazuar.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

MALLTEZI K. BALLA

Vendimi nr.8144, dt.12.7.2013

Në gjykimin civil dhe të drejtën e detyrimeve në dallim nga e drejta penale, vlen parimi i prezumimit të fajësisë. Paditësi ka detyrimin vetëm të provojë deklaratimet e të paditurit që i kanë cenuar nderin dhe personalitetin e pastaj barra e provës për të provuar faktet që qëndrojnë në bazë të deklarimeve bien mbi palën e paditur. Për të provuar ekzistencën e këtij dëmi, mjafton edhe vetëm fakti i paraqitjes së padisë në gjykatë gjë që provon se cenim i botës së brendshme të paditësit e ka detyruar atë t'i drejtohet me padi gjykatës për të rivendosur në vend të drejtën e cenuar. Pranimin e padisë.

Faktet

Paditësi pretendon se i padituri me detyrën deputet në Kuvendin e Shqipërisë, ka deklaruar fakte të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tij, të cilat kanë fyer nderin dhe dinjitetin e paditësit. Deklaratat konsistojnë në akuza për përfitime nga privatizime të objekteve publike në kundërshtim me ligjin, duke qenë se paditësi është bashkëshorti i vajzës së Kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha.

Paditësi pretendon se këto deklarata janë tërësisht të pavërteta dhe përbëjnë fyerje kundrejt tij duke cenuar nderin dhe dinjitetin e tij. Ai kërkon dëmshpërblim moral dhe përgënjeshttrim të tyre nga i padituri.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se nga i padituri nuk u soll asnjë provë për të vërtetuar thëniet e tij. Gjykata vlerëson 4 elementët e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar paditësit. Kundërligjshmëria e veprimeve të të paditurit prezumohet pasi ai nuk solli prova të vërtetonte pretendimin e tij për faktet që përmban deklaratat. Ai i ka mbështetur ato në fjalë dhe thënie të pavërteta duke cenuar nderin dhe dinjitetin e paditësit. Ky i fundit është cenuar

në dinjitetin e tij, duke qenë se ai është një njeri i respektuar në shoqëri dhe profesion për shkak të formimit dhe pozicionit të tij. Duke bërë publike thënie të pavërteta, atij i është shkaktuar dëm i rëndë. Lidhur me fajësinë, ajo konstaton se i padituri në rolin e tij si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ka vepruar me faj në formën e dashjes për shkak se e dinte dhe mund të parashikonte se përdorimi i deklaratave të pabaza, në drejtim të paditësit do të shkaktonte dëm në nderin dhe personalitetin e paditësit. I padituri nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën. Po ashtu vërtetohet edhe lidhja shkakësore midis veprimit të paligjshëm dhe dëmit të shkaktuar.

Sa i takon masës së dëmshpërblimit, gjykata vlerëson se shuma prej 1000.000 lekë konsiderohet si shumë e arsyeshme duke mbajtur parasysh: rëndesën e akuzave, personalitetin social të paditësit, pozitën e të paditurit, mundësinë e këtij të fundit për të përgënjeshtuar thëniet, pagën e të paditurit. Për këto arsye, padia pranohet.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit	X	

MALLTEZI, BERISHA K. TAHIRI

Vendimi nr.6538, dt.25.6.2012

Në gjykimin civil dhe të drejtën e detyrimeve në dallim nga e drejta penale, vlen parimi i prezumimit të fajësisë. Paditësi ka detyrimin vetëm të provojë deklaratimet e të paditurit që i kanë cenuar nderin dhe personalitetin e pastaj barra e provës për të provuar faktet që qëndrojnë në bazë të deklaratimeve bien mbi palën e paditur. Për të provuar ekzistencën e këtij dëmi, mjafton edhe vetëm fakti i paraqitjes së padisë në gjykatë gjë që provon se cenim i botës së brendshme të paditësit e ka detyruar atë t'i drejtohet me padi gjykatës për të rivendosur në vend të drejtën e cenuar. Fakti që paditësit kanë të ardhura të konsiderueshme nuk mund t'u mohojë atyre të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim për dëmin jopasuror. Morali dhe dinjteti i personit nuk ka çmim dhe nuk ka formulë llogaritëse, por gjykata në caktimin e saj nisat nga kritere dhe praktika tashmë të konsoliduara. Pranimin e padisë.

Faktet

Paditësit, fëmijët e kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha, pretendojnë se i padituri, me detyrën deputet në Kuvendin e Shqipërisë, ka deklaruar fakte të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tyre, të cilat kanë fyer nderin dhe personalitetin e paditësve. Deklaratat konsistojnë në akuza për përfshirje në afera korruptive dhe të dyshimta të paditësve për shkak të qenies së tyre familjarë të ngushtë të Kryeministrit. Faktet korruptive, sipas të paditurit, i referohen çështjeve që lidhen me kompleksin energjitik në Porto Romano dhe me çështjen e tragjedisë së Gërdecit

Paditësit pretendon se këto deklarata janë tërësisht të pavërteta dhe përbëjnë fyerje kundrejt tyre duke cenuar nderin dhe personalitetin e tij. Ai kërkon dëmshpërblim moral dhe përgënjeshtrim të tyre nga i padituri, i cili ka vepruar me faj me qëllim denigrimin e figurës së tyre në publik.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se i padituri është një subjekt që ka një mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta lidhur me lirinë e shprehjes (neni 73 i Kushtetutës). Funkzioni dhe detyra e deputetit lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë mbrojtje nga neni 73 i Kushtetutës, pasi: së pari deklaratat nuk janë bërë në ambjentet e Kuvendit ose të tjera të barazuara me të. Ato nuk ishin as riprodhim i deklaratave të bërë gjatë punimeve të Kuvendit. Ato janë bërë në një emision televiz duke përmendur emrat e paditësve qëllimisht. Së dyti, nuk është në misionin e deputetit të bëjë akuza publike për fakte konkrete. Ai mund ti denoncojë në organet e prokurorisë pasi të ketë bërë kallëzim sipas rregullave procedurale. Së treti, pohimet e palës së paditur nuk u provuan të ishin të vërteta. I padituri, nisur nga funksioni që ka dhe në emër të interesit publik nuk mund të disinformojë apo të cenojë me qëllim individët pa respektuar parime të së drejtës të tilla si prezumimi i pafajsisë apo barrën e provës për akuzat që ngrenë.

Nga i padituri nuk u soll asnjë provë për të vërtetuar thëniet e tij. Gjykata vlerëson 4 elementët e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktura paditësit. Kundërligjshmëria e veprimeve të paditurit prezumohet pasi ai nuk solli prova të vërtetonte pretendimin e tij për faktet që përmban deklaratat. Ai i ka mbështetur ato në fjalë dhe thënie të pavërteta duke cenuar nderin dhe dinjitetin e paditësve. Këta të fundit janë cenuar në dinjitetin e tyre, duke qenë se ata janë persona të respektuar në shoqëri dhe profesion për shkak të angazhimit të tyre profesional. Duke bërë publike thënie të pavërteta, atyre u është shkaktuar dëm i rëndë. Lidhur me fajësinë, ajo konstaton se i padituri në rolin e tij si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ka vepruar me faj në formën e dashjes për shkak se e dinte dhe mund të parashikonte se përdorimi i deklaratave të pabaza, në drejtim të paditësve do të shkaktonte dëm në nderin dhe personalitetin e tyre. I padituri nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën. Po ashtu vërtetohet edhe lidhja shkakësore midis veprimit të paligjshëm dhe dëmit të shkaktuar.

Sa i takon masës së dëmshpërblimit, gjykata vlerëson se shuma prej 1000.000 lekë konsiderohet si shumë e arsyeshme duke mbajtur parasysh: ciësitë e paditësve dhe të të paditurit, rëndesën e akuzave, personalitetin social të paditësit, pozitën e të paditurit, mënyrën e përhapjes së thënieve (nëpërmjet televizionit), mundësinë e të paditurit për të përgënjeshtruar thëniet, pagën e të paditurit. Për këto arsye, padia pranohet.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit	X	

Vokshi k. Braçe

Vendimi nr.1072, dt.9.2.2012

Funksioni dhe detyra e deputetit lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë mbrojtje nga neni 73 i Kushtetutës, pasi nuk është në misionin e deputetit të bëjë akuza publike për fakte konkrete duke thënë gjëra të pabazuara dhe disinformuese. I padituri, nisur nga funksioni që ka dhe në emër të interesit publik nuk mund të disinformojë apo të cenojë me qëllim individët pa respektuar parime të së drejtës të tilla si prezumimi i pafajësisë apo barrën e provës për akuzat që ngrenë. Pranimi i padisë.

Faktet

Paditësi dhe i padituri janë deputetë në Kuvendin e Shqipërisë. I padituri, me datë 1.9.2010 në një deklaratë për shtyp të mbajtur në ambjentet e Partisë Socialiste, deputet i së cilës është, është shprehur se paditësja ka qenë në konflikt interesi si anëtare e këshillit mbikëqyrës duke i dhënë me koncesion kompanisë ku është ortak bashkëshorti i saj. Paditësja pretendon se këto deklarata janë tërësisht të pavërteta dhe përbëjnë fyerje kundrejt saj duke cenuar nderin dhe dinjitetin e saj. Ajo kërkon dëmshpërblim moral dhe përgënjeshttrim të tyre nga i padituri ka deklaruar fakte të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tij.

I padituri nuk i mohoi deklaratat e bëra por kërkoi që paditësja të provonte se deklaratat e tij janë të pavërteta.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se nga i padituri nuk u soll asnjë provë për të vërtetuar thëniet e tij. Gjykata vlerëson 4 elementët e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar paditësit. Kundërligjshmëria e veprimeve të të paditurit prezumohet pasi ai nuk solli prova të vërtetonte pretendimin e tij për faktet që përmban deklaratat. Ai i ka mbështetur ato në fjalë dhe thënie të pavërteta duke cenuar

nderin dhe dinjitetin e paditëses. Kjo e fundit është cenuar në dinjitetin e saj, duke qenë se ajo është një njeri i respektuar në shoqëri dhe profesion për shkak të formimit dhe pozicionit të saj. Duke bërë publike thënie të pavërteta, asaj i është shkaktuar dëm i rëndë.

Gjykata vlerëson se i padituri është një subjekt që ka një mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta lidhur me lirinë e shprehjes (neni 73 i Kushtetutës). Funkzioni dhe detyra e deputetit lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë mbrojtje nga neni 73 i Kushtetutës, pasi nuk është në misionin e deputetit të bëjë akuza publike për fakte konkrete duke thënë gjëra të pabazuara dhe disinformuese. I padituri, nisur nga funksioni që ka dhe në emër të interesit publik nuk mund të disinformojë apo të cenojë me qëllim individët pa respektuar parime të së drejtës të tilla si prezumimi i pafajsisë apo barrën e provës për akuzat që ngrenë.

Lidhur me fajësinë, ajo konstaton se i padituri në rolin e tij si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ka vepruar me faj në formën e dashjes për shkak se e dinte dhe mund të parashikonte se përdorimi i deklaratave të pabaza, në drejtim të paditëses do të shkaktonte dëm në nderin dhe personalitetin e saj. I padituri nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën. Po ashtu vërtetohet edhe lidhja shkakësore midis veprimit të paligjshëm dhe dëmit të shkaktuar.

Sa i takon masës së dëmshpërblimit, gjykata vlerëson se shuma prej 1000.000 lekë konsiderohet si shumë e arsyeshme duke mbajtur parasysh: rëndesën e akuzave, personalitetin social të paditësit, pozitën e të paditurit, mundësinë e këtij të fundit për të përgënjeshtuar thëniet, pagën e të paditurit, proporcionalitetin e masës së dëmshpërblimit me dëmin e shkaktuar. Për këto arsye, padia pranohet.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik		X
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit	X	

BASHKIA TIRANË K. DALIPI

Vendimi nr.8802, dt.1.10.2012

Deklaratat të cilat nuk paraqesin realitetin synojnë të ndikojnë negativisht në opinionin e komunitetit duke mbajtur në vëmendje se shtypi viziv dhe jo viziv, si pushtet i katërt, ka një influencë të rëndësishme në opinionin e qytetarit. Megjithëse pala paditëse duhet të jetë e përgatitur të përballojë deklaratat të ndryshme, në rastin e shprehjeve të pavërteta sidomos kur lidhen me asfera korruptive, ajo ka të drejtë të gëzojë mbrojtje për cenimin e nderit dhe personalitetit. E kundërta do të thotë që dëmi që i vjen palës paditëse është më i madh se përfitimi që ka shoqëria nga ushtrimi pa kufij i së drejtë së shprehjes. Pranim i padisë.

Faktet

Paditësi ka ngritur padi me pretendimin se i padituri, me detyrë anëtar i Këshillit Bashkiak përfaqësues i Partisë Socialiste, ka shpifur kur ka deklaruar se Bashkia Tiranë dhe kryetari i saj i kanë dhënë fondet për dekore të festës së pavarësisë kompanive private pranë familjes së Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Këto deklarime i janë drejtuar Bashkisë si institucion dhe kryetarit të saj duke aluduar për korrupsion me fonde publike. Deklaratat janë publikuar në media vizive dhe të shkruar. Pala paditëse kërkon dëmshpërblim moral dhe përgënjeshttrim të tyre nga i padituri ka deklaruar fakte të pavërteta dhe shpifje në drejtim të saj.

I padituri nuk i mohoi deklaratat e bëra por theksoi që ato janë bërë në cilësinë e tij si anëtar i këshillit bashkiak.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se në bazë të ligjit për qeverisjen vendore, i padituri ka vepruar në cilësinë e tij si anëtar i këshillit bashkiak që ka detyrimin për tu informuar lidhur mesa shpenzohet nga fondi i bashkisë. Ligji i njeh atij të dretjën për të kërkuar lloga-

ri dhe informacion lidhur mesa interesohet. Gjykata vlerëson 4 elementët e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar paditësit. Kundërligjshmëria e veprimeve të të paditurit lidhet me përdorimin e fjalëve që çenojnë nderin dhe dinjitetin e personit. I padituri nuk solli prova të vërtetonte pretendimin e tij për faktet që përmban deklaratat. Ai i ka mbështetur ato në fjalë dhe thënie të pavërteta duke cenuar nderin dhe dinjitetin e paditësit. Kjo e fundit është cenuar në dinjitetin e tij, duke qenë se kryetari i bashkisë është person publik. Duke bërë publike thënie të pavërteta, atij dhe institucionit që drejton i është shkaktuar dëm i rëndë.

Gjykata vlerëson se i padituri është një subjekt që ka një mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta lidhur me lirinë e shprehjes për shkak të aktivitetit të tij politik. Funkcioni dhe detyra e tij si anëtar i këshillit bashkiak lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë mbrojtje lidhur me fakte të disinformuese dhe të pavërteta. I padituri, nisur nga funksioni që ka dhe në emër të interesit publik nuk mund të disinformojë apo të cenojë me qëllim individët pa respektuar parime të së drejtës të tilla si prezumimi i pafajsisë apo barrën e provës për akuzat që ngrenë.

Lidhur me fajësinë, ajo konstaton se i padituri në rolin e tij si përfaqësues i një force politike kundërshtare me forcën që drejton Bashkinë Tiranë, ka vepruar me faj në formën e dashjes për shkak se e dinte dhe mund të parashikonte se përdorimi i deklaratave të pabaza, në drejtim të paditësit do të shkaktonte dëm në nderin dhe personalitetin e tij. I padituri nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën. Po ashtu vërtetohet edhe lidhja shkakësore midis veprimit të paligjshëm dhe dëmit të shkaktuar.

Sa i takon masës së dëmshpërblimit, gjykata vlerëson se shuma prej 1000.000 lekë konsiderohet si shumë e arsyeshme duke mbajtur parasysh: rëndesën e akuzave, personalitetin social të paditësit, pozitën e të paditurit, mundësinë e këtij të fundit për të përgënjeshtuar thëniet, pagën e të paditurit, proporcionalitetin e masës së dëmshpërblimit me dëmin e shkaktuar. Për këto arsye, padia pranohet.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik		X
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit	X	

PANGO K. TOP CHANNEL SH.A

Vendimi nr.3806, dt.24.3.2014

Roli i medias është i rëndësishëm pasi informon publikun e gjerë për të qenë kritikë ndaj politikanëve. Pa një rol të tillë shoqëria do të ishte e pamundur të kontrollonte sjelljet e funksionarëve dhe rrjedhimisht nuk do të krijonte dot asnjë përfytyrim tjetër përveç asaj që do t'i ofronin vetë këta funksionarë. Gjykata i jep prioritet mbrojtjes së moralit dhe interesit publik duke pranuar një standard të ndryshëm gjykimi në rastin e paditësit si politikan dhe person publik. Rrëzimi i padisë.

Faktet

Paditësi ka ngritur padi me pretendimin se i padituri, ka publikuar të dhëna të pasakta jo të vërteta të përfutuara në mënyrë të kundërligjshme. Në një emision televiziv të transmetuar nga i padituri (shoqëri mediatike) është publikuar një video e përfutur nga kamera e fshehtë, e cila kishte në qendër të saj paditësin, i cili kërkonte favore seksuale në këmbim të vendit të punës. Paditësi, në momentin e filmimit ka qenë me detyrë Drejtor në Ministrinë e Kulturës. Paditësi kërkon dëmshpërblim moral dhe përgënjeshttrim të tyre nga i padituri pasi faktet e publikuara janë të pavërteta. Ai pretendon se nga këto filmime atij iu shemb gjithë jeta e tij në pak orë, pasi efekti i filmimeve ishte i tillë që denigronte figurën e tij.

I padituri prapësoi pretendimet duke parashtruar se filmimet janë të vërteta dhe të pamontuara. Sa i takon transmetimit të tyre, është detyrë e medias të përçojë tek publiku fakte e rrethana që nxjerrin në pah akte korruptive të punonjësve të administratës publike. Nuk është faji i medias por i fakteve që paraqesin filmimet ku merr pjesë paditësi që i kanë dëmtuar atij personalitetin. Faktet e paraqitura në filmim janë reale dhe të pakundërshtueshme dhe ato kanë ardhur si pasojë e veprimeve të paditësit, jo të të paditurit. Ky i fundit vetëm i ka transmetuar ato publikut.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se liria e medias dhe e informimit është një e drejtë e garantuar në bazë të nenit 22/2 të Kushtetutës. Po kështu edhe e drejta e informimit (neni 23 i Kushtetutës). Roli i medias është i rëndësishëm pasi informon publikun e gjerë për të qenë kritikë ndaj politikanëve. Pa një rol të tillë shoqëria do të ishte e pamundur të kontrollonte sjelljet e funksionarëve dhe rrjedhimisht nuk do të krijonte dot asnjë përfytyrim tjetër përveç asaj që do t'i ofronin vetë këta funksionarë. Pamjet ku shfaqet paditësi janë kompromentuese dhe të pamoralshme, ku personit tjetër në filmim i kërkohet favor seksual në këmbim të vendit të punës. Publiku i gjerë reagoi ashpër, po kështu edhe qeveria, ku bënte pjesë edhe paditësi si funksionar i lartë. Mbrojtja e moralit është çështje me interes publik dhe si e tillë merr përparësi ndaj mbrojtjes së jetës private. Për këtë arsye, paditësi nuk ka të drejtë të pretendojë mbrojtje kushtetuese në këtë pikë.

E drejta e mediave për të informuar publikun për çështje të interesit publik është e garantuar, ndërsa mbrojtja e funksionarëve publikë sa i takon privatësisë është e ndryshme nga mbrojtja e çdo personi jopublik. Gjykata i jep prioritet mbrojtjes së moralit dhe interesit publik duke pranuar një standard të ndryshëm gjykimi në rastin e paditësit si politikan dhe person publik.

Për këto arsye, padia rrëzohet.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë		X
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

BEGEJA ETJ K. BALLA

Vendimi nr.8144, dt.12.7.2013

Deklarimet e të paditurit me cilësinë e deputetit në rastin konkret nuk janë shpifje apo trillime të tij me qëllim për të diskredituar paditësat. Nga ana tjetër ajo janë jashtë interesit vetiak. Me cilësinë e deputetit dhe në përmbushje të kësaj detyre ai ka shprehur mendime dhe opinione të bazuara në disa prova e fakte të vërteta. Thelbi i deklarimeve të tij ka të bëjë me mbrojtjen e pronës publike kundër abuzimeve dhe veprimeve të paligjshme nga institucionet e shtetit. Rrëzimi i padisë.

Faktet

Paditësit pretendojnë se i padituri, me detyrën deputet në Kuvendin e Shqipërisë, ka deklaruar fakte të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tyre, të cilat kanë fyer nderin dhe dinjitetin e paditësve. Deklaratat konsistojnë në akuza drejtuar personave të tretë por që në thelb lidhen me përfitim nga procesi i privatizimit të një prone shtetërore, e cila është përfituar nga paditësit. Sipas deklaratave, privatizimi i objekteve publike është bërë në kundërshtim me ligjin, duke qenë se përfituesi kryesor ka qenë bashkëshorti i vajzës së Kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha.

Paditësit pretendojnë se këto deklarata janë tërësisht të pavërteta dhe përbëjnë fyerje kundrejt tyre, pasi ata e kanë përfituar pronën sipas ligjit, duke qenë se kjo pronë u ishte shtetëzuar trashëgimlënësve të tyre nga regjimi komunist. Ata kishin marrë pjesë në procesin e privatizimit dhe si ish pronarë kanë përfituar të drejtën e parablerjes. Paditësit ndihen të cenuar në nderin dhe dinjitetin e tyre duke i akuzuar se kanë përfituar pronën e tyre në mënyrë të kundërligjshme. Ata kërkon dëmshpërblim moral dhe përgënjeshttrim të tyre nga i padituri.

I padituri prapësoi duke deklaruar se nuk është përmendur asnjëherë emri i paditësve në deklarata dhe se ai këto deklarime i ka të mbështetura në prova. Përveç kësaj ai si deputet nuk mund

të mos shprehet kur vëren fakte paligjshmërie në privatizimin e pronave publike.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se Kushtetuta i ka dhënë mbrojtje të posaçme deputetit të Kuvendit me qëllim realizimin e detyrës së tij ndaj zgjedhësve. Deklarimet e të paditurit me cilësinë e deputetit në rastin konkret nuk janë shpifje apo trillime të tij me qëllim për të diskretituar paditësat. Nga ana tjetër ajo janë jashtë interesit vetiak. Me cilësinë e deputetit dhe në përmbushje të kësaj detyre ai ka shprehur mendime dhe opinione të bazuara në disa prova e fakte të vërteta. Thelbi i deklarimeve të tij ka të bëjë me mbrojtjen e pronës publike kundër abuzimeve dhe veprimeve të paligjshme nga institucionet e shtetit. Deputeti duhet të ketë mundësi të për të shfaqur hapur dhe i pacensuruar opinionet e tij, të cilat përbëjnë vullnet politik për të cilin është votëbesuar nga zgjedhësit. Kjo bëhet më e rëndësishme kur opinionet e tij drejtohen kundër dukurive negative. Gjykata vlerëson se i padituri nuk ka kryer veprime të kundërligjshme me faj në dëm të paditësve për rrjedhojë padia rrëzohet.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë		X
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi	X	
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

PERLESHA K. GAZETËS ZËRI I POPULLIT

Vendimi nr.7045, dt. 21.06.2013

Qëllimi i artikullit ka qenë sensibilizimi i publikut lidhur me një dukuri negative dhe për këtë arsye nuk janë përmendur emrat konkretë të personave me të cilët lidhet ngjarja e pamoralshme. Gjithashtu, artikulli synonte të vinte në presion edhe personat përgjegjës për mosveprim ndaj kësaj situatë dhe nuk drejtohej ndaj paditësit. Rrëzimi i padisë.

Faktet

Në gazetën Zëri i Popullit, datë 24.07.2012, konkretisht në faqen 10 të saj, është botuar një artikull me titullin “A kanë moral oficerët e policisë së shtetiti?” Ndër të tjera, në këtë artikull thuhet se dy oficerë policie në qarkun e Dibrës janë akuzuar si shkaktarë të ndarjes së një çifti pas 20 vjetësh për shkak se gruas së çfritit i ishin gjetur dy numra celularë që i korrespondojnë dy oficerëve të policisë. Më tej artikulli vazhdon, se oficerët e policisë të veshur me uniformë shfrytëzojnë dhe abuzojnë me shtetas për shkak të detyrës.

Paditësi ka paraqitur para para gjykatës padinë duke pretenduar se një nga numrat e publikuar të celularit i përket atij dhe si i tillë ai ndihet i cenuar në nderin dhe personalitetin e tij pasi deklaratat janë të rreme dhe denigruese.

Pala e paditur prapësoi se artikulli nuk kishte emra por vetëm numrat e telefonit. Qëllimi i deklaratës nuk ishin emrat konkretë të oficerëve të policisë por morali i institucioneve të zbatimit të ligjit.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se personat të cilëve u atribuohet ngjarja nuk janë identifikuar me emër mbiemër apo të dhëna të tjera por janë bërë publike vetëm numrat e telefonit, pa pjesën e parë që identifikon shoqërinë telefonike. Qëllimi i artikullit ka qenë

sensibilizmi i publikut lidhur me një dukuri negative dhe për këtë arsye nuk janë përmendur emrat konkretë të personave me të cilët lidhet ngjarja e pamoralshme. Gjithashtu, artikulli synonte të vinte në presion edhe personat përgjegjës për mosveprim ndaj kësaj situate.

Nuk u provua se paditësi ishte mbajtës i njërit prej numrave celularë. Pavarësisht se ai solli faturat e shoqërisë përkatëse, numrat janë lëshuar në emër të Drejtorisë së Policisë dhe jo personave konkretë. Si përfundim, gjykata nuk arriti të konstatojë dëm ndaj paditësit dhe veprim të kundërligjshëm të të paditurit. Për këtë shkak u vendos rrëzimi i padisë.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit		X
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik		X
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

BREÇANI K. SHOQËRIA FOCUS PRESS DHE FOCUS MEDIA NEWS SHPK

Vendimi nr.10257 dt. 30.11.2012

Informacioni i botuar duhet të jetë i vërtetë dhe autentik, pra të ketë përputhshmëri midis fakteve që kanë ndodhur dhe atyre që tregohen, të ketë interes publik në atë që tregohet dhe korrektësi në botim me qëllim parandalimin e prekjës së dinjitetit dhe personalitetit të individit. Dallimi midis atyre që quben fakte dhe opinione është i qartë: opinionet janë pikëpamje personale të një ngjarje apo situata, faktet mbi të cilat bazohen opinionet duhet të provohen si të vërteta. Ekzistenca e fakteve mund të dëshmohet, kurse vlerësimet nuk mund të dëshmohen. I gjithë informacioni i dhënë nuk i është nënshtruar verifikimit për vërtetësinë e tij. Cenimi i personalitetit të individit nga fakte të rreme shkakton dhimbje të brendshme dhe vuajtje shpirtërore dhe si e tillë përbën cenim të drejtave themelore të individit. Pranimi i padisë.

Faktet

Në gazetën Shqiptare dhe Televizionin News24 të datës 30.09. 2010 dhe 4.10.2010, është publikuar deklarata me përmbajtje që lidhej me qenien e paditëses (njëkohësisht edhe e afërt me Kryeministrin e Shqipërisë) si bashkëpunëtore në biznes me aktivitete të dyshuara për lidhje me rrjete mafioze.

Në mungesë të vullnetit të palës së paditur për të përgënjeshtuar lajmin e dhënë, paditësja ka paraqitur para para gjykatës padinë duke pretenduar se për shkak të thënieve të pavërteta ajo ndihet e cenuar në nderin dhe personalitetin e saj.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se mediave vizive dhe të shkruara u garantohej liria e tyre deri në kufizirin e paprekshmërisë së dinjitetit dhe personalitetit të individit. I padituri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij meidatik duhet që të respektojë disa parametra. Infor-

macioni i botuar duhet të jetë i vërtetë dhe autentik, pra të ketë përputhshmëri midis fakteve që kanë ndodhur dhe atyre që tregohen, të ketë interes publik në atë që tregohet dhe korrektësi në botim me qëllim parandalimin e prekjës së dinjitetit dhe personalitetit të individit. Dallimi midis atyre që quhen fakte dhe opinione është i qartë: opinionet janë pikëpamje personale të një ngjarje apo situata, faktet mbi të cilat bazohen opinionet duhet të provohen si të vërteta. Ekzistenca e fakteve mund të dëshmohet, kurse vlerësimet nuk mund të dëshmohen. Në rastin në gjykim, shkrimi nuk bazohet në fakte të provuara dhe në këtë mënyrë paditësja është prekur në nderin dhe personalitetin e saj. Nuk rezulton asnjë provë mbi fillimin e hetimit të veprimtarive të shoqërive me të cilat bashkëpunon paditësja. I gjithë informacioni i dhënë nuk i është nënshtruar verifikimit për vërtetësinë e tij. Cenimi i personalitetit të individit nga fakte të rreme shkakton dhimbje të brendshme dhe vuajtje shpirtërore dhe si e tillë përbën cenim të drejtave themelore të individit.

Gjykata arriti të provonte të katër elementët e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar paditëses. Kundërligjshmëria e veprimeve të të paditurit lidhet me përdorimin e fjalëve që çenojnë nderin dhe dinjitetin e personit. I padituri nuk solli prova të vërtetonte pretendimin e tij për faktet që përmban deklarata. Ai i ka mbështetur ato në fjalë dhe thënie të pavërteta duke cenuar nderin dhe dinjitetin e paditëses. Duke bërë publike thënie të pavërteta, asaj i është shkaktuar dëm i rëndë.

Lidhur me fajësinë, ajo konstaton se i padituri në rolin e tij si media ka vepruar me faj në formën e dashjes për shkak se e dinte dhe mund të parashikonte se përdorimi i deklaratave të pabaza, në drejtim të paditëses do të shkaktonte dëm në nderin dhe personalitetin e saj. I padituri nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën. Po ashtu vërtetohet edhe lidhja shkakësore midis veprimit të paligjshëm dhe dëmit të shkaktuar.

Sa i takon masës së dëmshpërblimit, gjykata vlerëson se shuma prej 3 000.000 lekë konsiderohet si shumë e arsyeshme duke mbajtur parasysh: rëndesën e akuzave, personalitetin social të paditësit, pozitën e të paditurit, mundësinë e këtij të fundit për të përgënjeshtuar thëniet, pagën e të paditurit, proporcionalite-

tin e masës së dëmshpërblimit me dëmin e shkaktuar. Gjithashtu gjykata detyron të paditurit të bëjnë përgenjeshtrimin për deklaratat e pavërteta të bëra në drejtim të paditëses. Për këto arsye, padia pranohet.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve	X	
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje		X
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

VOKSHI K. TAHIRI

Vendimi nr.16, dt.11.1.2013

Funksioni dhe detyra e deputetit lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë mbrojtje nga neni 73 i Kushtetutës, pasi nuk është në misionin e deputetit të bëjë akuza publike për fakte konkrete duke thënë gjëra të pabazuara dhe disinformuese. I padituri, nisur nga funksioni që ka dhe në emër të interesit publik nuk mund të disinformojë apo të cenojë me qëllim individët pa respektuar parime të së drejtës të tilla si prezumimi i pafajsisë apo barrën e provës për akuzat që ngrenë. Pranimin e padisë.

Faktet

Paditësi dhe i padituri janë deputetë në Kuvendin e Shqipërisë. I padituri, me datë 22.8.2010 në një deklaratë për shtyp të mbajtur në ambjentet e Partisë Socialiste, deputet i së cilës është, është shprehur se paditësja ka qenë në konflikt interesi si anëtare e këshillit mbikëqyrës duke i dhënë me koncesion kompanisë ku është ortak bashkëshorti i saj. Paditësja pretendon se këto deklarata janë tërësisht të pavërteta dhe përbëjnë fyerje kundrejt saj duke cenuar nderin dhe dinjitetin e saj. Ajo kërkon dëmshpërblim moral dhe përgënjeshttrim të tyre nga i padituri ka deklaruar fakte të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tij.

I padituri nuk i mohoi deklaratat e bëra por kërkoi që paditësja të provonte se deklaratat e tij janë të pavërteta.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se nga i padituri nuk u soll asnjë provë për të vërtetuar thëniet e tij. Gjykata vlerëson 4 elementët e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktura paditësit. Kundërligjshmëria e veprimeve të të paditurit prezumohet pasi ai nuk solli prova të vërtetonte pretendimin e tij për faktet që përmban deklaratat. Ai i ka mbështetur ato në fjalë dhe thënie të pavërteta duke cenuar

nderin dhe dinjitetin e paditëses. Kjo e fundit është cenuar në dinjitetin e saj, duke qenë se ajo është një njeri i respektuar në shoqëri dhe profesion për shkak të formimit dhe pozicionit të saj. Duke bërë publike thënie të pavërteta, asaj i është shkaktuar dëm i rëndë.

Gjykata vlerëson se i padituri është një subjekt që ka një mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta lidhur me lirinë e shprehjes (neni 73 i Kushtetutës). Funkzioni dhe detyra e deputetit lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë mbrojtje nga neni 73 i Kushtetutës, pasi nuk është në misionin e deputetit të bëjë akuza publike për fakte konkrete duke thënë gjëra të pabazuara dhe disinformuese. I padituri, nisur nga funksioni që ka dhe në emër të interesit publik nuk mund të disinformojë apo të cenojë me qëllim individët pa respektuar parime të së drejtës të tilla si prezumimi i pafajsisë apo barrën e provës për akuzat që ngrenë.

Lidhur me fajësinë, ajo konstaton se i padituri në rolin e tij si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ka vepruar me faj në formën e dashjes për shkak se e dinte dhe mund të parashikonte se përdorimi i deklaratave të pabaza, në drejtim të paditëses do të shkaktonte dëm në nderin dhe personalitetin e saj. I padituri nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën. Po ashtu vërtetohet edhe lidhja shkakësore midis veprimit të paligjshëm dhe dëmit të shkaktuar.

Sa i takon masës së dëmshpërblimit, gjykata vlerëson se shuma prej 1000.000 lekë konsiderohet si shumë e arsyeshme duke mbajtur parasysh: rëndesën e akuzave, personalitetin social të paditësit, pozitën e të paditurit, mundësinë e këtij të fundit për të përgënjeshtuar thëniet, pagën e të paditurit, proporcionalitetin e masës së dëmshpërblimit me dëmin e shkaktuar. Për këto arsye, padia pranohet.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik		X
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit	X	

VELIAJ K. GOXHAJ

Vendimi nr.2897, dt.3.7.2014 (Gjykata e Apelit Tiranë)

Liria për t'u shprehur garantohet nga Kushtetuta por deri në kufirin e paprekshmerisë së dinjitetit dhe personalitetit të individit. I padituri gjatë shprehjes së lirisë së mendimit duhet të respektojë disa parametra. Informacioni i botuar dhe i transmetuar duhet të ishte i vertetë dhe autentik, gjë e cila nënkupton përputhshmeri midis faktëve që kanë ndodhur dhe faktëve që tregohen, të këtyre interes publik në atë që tregohen, dhe korrektesë në botimin dhe transmetimin e faktëve në mënyrë që të parandalohet preklara e dinjitetit dhe personalitetit të individit. E drejta e personalitetit ka për objekt mënyrën e jetesës, fizike apo morale të individit. Personaliteti i tij manifestohet në shoqëri ku ai jeton dhe për rrjedhim është kjo e fundit që njihet dhe vlerësohet vlerat e dinjitetit njerezore. Në këtë kuptim çenimi i personalitetit dhe dinjitetit duke shkaktuar dëmtime të brendshme e vuajtje shpirtërore si individ dhe anëtar i shoqërisë të shkaktohet nga vepra e paligjshme e të paditurit përben çenim të të drejtave të personalitetit të mbrojtur nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Lenien në fuqi e vendimit.

Faktet

I padituri në mënyrë periodike ka botuar në disa gazeta akuzat të tilla se paditësi gjatë kohës kur drejtonte një grupim politik të quajtur “G99” dhe “Mjaft” ka përvetësuar vlera monetare të këtij grupimi, ka bërë evazion fiskal apo transferuar këto vlera nga njëra llogari në tjetrën në mënyrë të paligjshme. Konkretisht në gazetën Standard, datë 05.06.2009 i padituri ka shkruar artikullin “Velias dhe i vëllai, evazion fiskal me shifra qindra milionë lekë”. Në artikull thuhet: “Erion Velias zhdukuri bashkë me të vëllanë 300 mijë euro kredi për biznesin rinor. Më tej në gazetën Sot vazhdon: “Skandali, partia e Velias merr paratë e amerikaneve për të vëzhguar zgjedhjet e 28 qershorit”. Më tej në një emision televiziv në Vizion Plus është shprehur: “unë besoj se Erioni në historinë e viteve 2003-2009 për shumën 5.4

milionë euro të donatorëve që i ka siguruar nëpërmjet Mjaft ka bërë evazion fiskal.”

Për këtë përmbajtje paditësi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar dëmshpërblim, pasi ai ndihet i fyer në personalitetin e tij nga përmbajtja e deklaratave që janë tërësisht të pavërteta. Ai kërkon dëmshpërblim në shumën prej 10 mijë euro.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. I padituri ushtroi ankim në Gjykatën e Apelit me pretendimin se nuk ka marrë pjesë në gjykim dhe se vendimi i gjyqesës është i pambeshtetshëm në prova dhe në fakte. Gjate seancave gjyqësore ai pretendon se i është mohuar e drejta të paraqes prova dhe faket të cilat ndodheshin në fashikullin e çështjes penale nr.32 Regj them. date 15.06.2010, të regjistruar në dhomen penale të Gjyqesës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe çështjes penale nr.1194 date regjistrimi 12.04.2012.

Mbi ankimin e të paditurit, Gjykata e Apelit Tiranë shqyrtoi çështjen si më poshtë.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se nga aktet e dosjes, ndryshe sa është pretenduar në ankim, rezulton se gjykata në gjykimin e çështjes i ka dhënë mundësi pales së paditur për të degjuar duke e thirrur rregullisht në gjykim, rezulton se i padituri për mbrojtjen e interesave të tij të ketë dhënë prokurë përfaqësimi shoqërisë “2Win partners & Associates” shpk me administrator Av. Isuf Shehu, anëtar i dhomes së avokatise Tiranë. Gjithashtu edhe nga përmbajtja e procesverbalit gjyqësor rezulton se përfaqësuesi me prokurë i të paditurit Av. Isuf Shehu, ka parashtruar parapesimet lidhur me objektin e gjykimit, gjykata ka zbatuar e ndjekur parimin e kontradiktoritetit sipas nenit 18 e 20 të K.Pr.Civile. Në fakt është vetë pala e paditur e cila në seancën e fundit ka lënë gjykimin në mungesë.

I pabazuar në prova gjendet dhe pretendimi i pales së paditur përse i përket zgjidhjes në themel të çështjes, në ankim i padituri ka pretenduar se gjate seancave gjyqësore si pale e paditur i është mohuar e drejta të paraqes prova dhe faket të cilat

ndodheshin ne fashikullin e çeshtjes penale nr. 32 rregj.them. date 15.06.2010 te rregjistruar ne dhomen penale te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe çeshtjes penale nr.1194 date rregjistrimi 12.04.2012.

Gjykata e Apelit i krijoi te gjitha mundesite pales se paditur per te paraqitur provat e pretendura prej saj, duke shtyre per kete shkak séancen gjyqesore te dates 13.06.3013 per me date 02.07 2014 ora 9.00, prova te cilat pala e paditur nuk kerkoj qe te merren per shqyrtim ne kete shkalle gjykimi.

Liria per t'u shprehur garantohej nga Kushtetuta por deri ne kufirin e paprekshmerise se dinjitetit dhe personalitetit te individit. I padituri gjate shprehjes se lirise se mendimit duhet te respektonte disa parametra. Informacioni i botuar dhe i transmetuar duhet te ishte i vertete dhe autentik, gjë e cila nenkupton perputhshmeri midis fakteve qe kane ndodhur dhe fakteve qe tregohen, te kete interes publik ne ate qe tregohen, dhe korrektesi ne botimin dhe transmetimin e fakteve ne menyre qe te parandalohet prekja e dinjitetit dhe personalitetit te individit.

I padituri ne artikujt e botuar dhe informacionin e transmetuar ka deklaruar informacione per perfshirjen e paditesit ne pervetesimin e vlerave monetare te disa grupimeve politike gjate kohes kur ai i drejtonte keto grupime apo ka konsumuar vepren penale te evazionit fiskal. Rezulton nga aktet e dosjes se kjo e fundit eshte bere edhe objekt i hetimit nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesore Tirane, e cila me vendimin e dates 30 qershor 2010 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr.3379, viti 2009 per vepren penale te “mospagimit te taksave dhe tatimeve”, parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veper penale.

Ne keto rrethana rezulton se deklarimet e te paditurit te nderthurur me perhapjen e fakteve te rreme dhe te pasakta ka cenuar dinjitetin dhe personalitetin e paditesit me perhapjen gjeresisht tek publiku i gjere.

Nga provat shkresore te administruara ne gjykim nuk rezulton te jete inicuar ndonje hetim i Prokurorise se Rrethit Gjyqesore Tirane per pervetesim vlerash monetare nderkohe qe ai per evazion fiskal ka pushuar procedimin penal. I padituri ne kete

gjykim kishte barren e proves per te provuar se faktet e perhapura kane qene te verteta dhe autentike.

Shkrimet/artikujt e botuar dhe informacioni i transmetuar jo vetem qe nuk i eshte nenshtruar verifikimit per vertetesine e tij, por me perhapjen nepermjet tirazhit te materializuar nepermjet gazetave te perditshme ku jane botuar dhe valeve televizive kur jane transmetuar ka shkaktuar cenimin e vlerave te tilla qe gezojne mbrojtje konstitucionale per te cilat paditesi legjitimohet te kerkoje demshperblim.

E drejta e personalitetit ka per objekt menyren e jeteses, fizike apo morale te individit. Personaliteti i tij manifestohet ne shoqerine ku ai jeton dhe per rrjedhim eshte kjo e fundit qe njeh dhe vlereson vlerat e dinjitetit njerezore. Ne kete kuptim cenimi i personalitetit dhe dinjitetit duke shkaktuar dhimbje te brendshme e vuajtje shpirterore si individe dhe anetare i shoqerise te shkaktuar nga vepra e paligjshme e te paditurit perben cenim te te drejtave te personalitetit te mbrojtur nga Kushtetuta e Republikes se Shqiperise.

Gjykata e Apelit veren se nga ana e Gjykates se Rrethit jane verifikuar te gjitha elementet qe perbejne demin jashtekontraktor, sjelljen e paligjshem te te paditurit i cili ka botuar dhe transmetuar nepermjet emisionit televiziv informacion jo te vertete dhe korrekt, ekzistenca e demit perfaqesuar nga cenimi i personalitetit dhe moralit te paditesit, lidhjes shkaksore midis ketij fakti dhe cenimit te personalitetit, fajit ne formen e pakujdesise per shkak se i padituri (ne profesion edhe avokat) kerkon mbi te gjitha qe informacioni i botuar duhet te ishte i vertete dhe autentik dhe kjo arrihet nepemjet punes investiguese apo ballafaqese te paleve ne proces, dhe jo te botonte informacione te pa verifikuara me pare.

Ne lidhje me percaktimin e demit, Gjykata merr ne konsiderate cenimin e personalitetit dhe te dinjitetit te paditesit, faktin qe lajmi eshte perhapur me shpejtesi per shkak te tirazhit jo te vogel te gazetave dhe perdorimit te valeve televizive, e cila lehteson ne menyre te drejtepredrejte perhapjen tek publiku i gjere, te rolit qe paditesi ka ne aktivitetin ne jeten familjare dhe shoqerore, te mosbotimit te pergenjeshtrimit te lajmit nga i padituri,

veprimet me faj te pales se paditur për të krijuar një sensibilizim të opinionit publik për ato që ai i konsideron si abuzime me donacionet e fondet publike apo evazioni fiskal, (tema sensibile për publikun) që demshperblimi të mos shërbejë si qellim fitimi edhe për të caktuar një masë shpërblimi sa më të drejtë në raport me dëmin e shkaktuar ka konkluduar drejt se demshperblimi duhet të jetë i barabartë me 300.000 (treqind mijë) leke.

Në keto rrethana nuk ka vend që vendimi i gjyqes të cenohet, pasi është marrë në respektim të ligjit procedural dhe material duhet të lihet në fuqi.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

MALLTEZI K. BALLA

Vendimi nr.5571, dt.16.9.2014 (Gjykata e Apelit Tiranë)

Bërja publike e kësaj çështje vlerësohet nga gjykata e apelit si e rëndësishme për opinionin e gjerë, në rrethanat kur diskutohet për administrimin e pronave publike në kuadër të procesit të trajtimit nga shteti të pronave të ish-pronarëve, proces ky i tej zgjatur ndër vite dhe i diskutuar jo vetëm brenda vendit, por edhe në institucione ndërkombëtare. I padituri në cilësinë e deputetit të opozitës ka lirinë e shprehjes së opinionëve dhe gjykimeve të tij, madje duke lejuar deri diku edhe ndonjë tepri. Nga ana tjetër, pavarësisht se paditësi është ndierë i fyer në nderin dhe personalitetin e tij, kjo nuk mjafton për ta cilësuar veprimin e të paditurit si të kundërligjshëm. Deklaratat e bëra nga i padituri dhe të cilësuar nga paditësi si shpifje, në gjykimin e gjykatës së apelit, nuk vlerësohen të tilla, për sa kohë që ato e kanë një bazë faktike për shkak të së cilës janë bërë publike. Në cilësimin e veprimeve të të paditurit, gjykata e apelit, ndryshe nga ajo e shkallës së parë gjykon se qëllimi i vërtetë i të paditurit ka qenë shprehja e opinionit të tij dhe partisë që përfaqëson, lidhur me keq qeverisjen dhe posaçërisht mënyrës së administrimit të pasurive publike. Pranimi i ankimit.

Faktet

Paditësi pretendon se i padituri me detyrën deputet në Kuvendin e Shqipërisë, ka deklaruar fakte të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tij, të cilat kanë fyer nderin dhe dinjitetin e paditësit. Deklaratat konsistojnë në akuza për përfitime nga privatizime të objekteve publike në kundërshtim me ligjin, duke qenë se paditësi është bashkëshorti i vajzës së Kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha.

Paditësi pretendon se këto deklarata janë tërësisht të pavërteta dhe përbëjnë fyerje kundrejt tij duke cenuar nderin dhe dinjitetin e tij. Ai kërkon dëmshpërblim moral dhe përgënjeshttrim të tyre nga i padituri. Gjykata vendosi pranimin e padisë.

I padituri ushtroi ankim në Gjykatën e Apelit duke prete nduar se ai e ka bërë deklaratën në kuadër të funksionit të tij si

deputet i Kuvendit dhe si i tillë ai ka për detyrë të denoncojë shkelje që bëhen në kuadër të privatizimit të pronave publike. Ato janë fakte të vërteta dhe jo shpifje.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se gjykata e apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë, ndonëse referon në KEDNJ dhe jurisprudencën e GJEDNJ, nuk ka marrë në analizë pretendimet e të paditurit, lidhur me cilësimin ligjor të deklaratave, në kuptim të lirisë së shprehjes, e garantuar nga Kushtetuta dhe KEDNJ, ashtu si edhe e drejta e ruajtjes së nderit dhe personalitetit të paditësit. Gjykata e apelit ndonëse konstaton se paditësi legjitimohet në ngritjen e padisë përse ai është ndier i dëmtuar në nderin dhe personalitetin e tij, vlerëson se është në misionin e gjykatës për dhënien e drejtësisë, për ta zgjidhur çështjen, nën frymën e KEDNJ, e cila ka supremaci ndaj ligjit të brendshëm dhe vetë Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në nenin 10 të KEDNJ garantohet si një nga të drejtat dhe liritë themelore të individit, liria e shprehjes. Në lidhje me këtë të drejtë themelore, jurisprudenca e GJEDNJ ka vlerësuar rast pas rasti, ankimet lidhur me shkeljen e nenit 10, duke analizuar si kufizimin e së drejtës me ligjet e brendshme, qëllimin e këtij kufizimi, si edhe domosdoshmërinë e tij në një shoqëri demokratike.

Gjykata e apelit vlerëson gjithashtu të përmendë edhe disa raste të tjera në të cilat GJEDNJ rikonfirmon të njëjtat qëndrime, lidhur me lirinë e shprehjes dhe vlerësimin të domosdoshmërisë së kufizimit të saj në një shoqëri demokratike. Në çështjen Oberschlick (Nr.1) kundër Austrisë, GJEDNJ shprehet se liria e shtypit përbën një nga mjetet më të mira për krijimin e opinioneve mbi idetë dhe qëndrimet e figurave kryesore politike, dhe se liria e debatit politik qëndron në themelet e konceptit të shoqërisë demokratike. Për këtë arsye, GJEDNJ mban qëndrimin se kufijtë e pranimin të kritikës nga ana e politikanëve janë më të gjerë, në rastet kur ai vepron si person publik se sa në rastet kur paraqitet si individ i veçantë, pasi si person publik fjalët dhe deklaratat e tij janë nën vëzhgimin e hollësishëm të gazetarëve

dhe të publikut të gjerë. Për këtë arsye, shprehet GJEDNJ, ai (politikani) duhet të tregojë tolerancë, veçanërisht kur bën deklarata publike, të cilat janë të ndjeshme ndaj kritikës dhe kërkesa e tij për mbrojtje duhet të peshohet mirë me interesat për një diskutim sa më të hapur të çështjeve politike.

Duke i'u rikthyer rastit në shqyrtim, gjykata e apelit vlerëson pretendimin e paditësit për cenim të nderit dhe dinjitetit të tij, në raport me prapësimin e të paditurit lidhur me ushtrimin e lirisë së shprehjes, në kuadër të fakteve konkrete që lidhen me vendin e kryerjes së deklaratave, kontekstin, përmbajtjen e tyre, si dhe qëllimin e vërtetë të të paditurit, në raport me personat që përmenden në këto deklarime. Gjykata e apelit, duke vlerësuar në tërësi deklaratën e datës 09.10.2012, dhe jo vetëm frazat ku përmendet emri i paditësit, kupton se i padituri, politikan i Partisë Socialiste të Shqipërisë e njëkohësisht deputet i kësaj force politike në opozitë, ka bërë nëpërmjet medias një deklaratë politike, lidhur me administrimin nga Ministria e Mbrojtjes të pronave publike, e ndër to është përmendur edhe rasti i privatizimit të Kompleksit Sportiv "Partizani", në favor të ish-pronarëve, një prej të cilëve është edhe paditësi. Nga përmbajtja e deklaratës, e kryer nga ambientet e Partisë Socialiste, rezulton se ajo është kryer në vazhden e disa të tjerave, lidhur me të njëjtën çështje, shitjen nga Ministria e Mbrojtjes të pronave në administrim të saj. Kjo rezulton jo vetëm nga shpjegimet e të paditurit në proces, por edhe nga vetë përmbajtja e deklaratës, kur në pjesën hyrëse të saj rezulton se çështja lidhur me privatizimet e kryera nga Ministria e Mbrojtjes, është trajtuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë nëpërmjet deklaratave publike të saj, duke hedhur dyshime se nga Ministri i Mbrojtjes po abuzohej. Bërja publike e kësaj çështje vlerësohet nga gjykata e apelit si e rëndësishme për opinionin e gjerë, në rrethanat kur diskutohet për administrimin e pronave publike në kuadër të procesit të trajtimit nga shteti të pronave të ish-pronarëve, proces ky i tej zgjatur ndër vite dhe i diskutuar jo vetëm brenda vendit, por edhe në institucione ndërkombëtare, përfshirë GJEDNJ. I padituri, si i zgjedhur nga populli, ka kështu të drejtën për të bërë publike informacionet që disponon, si dhe për të shprehur gjykimet e opinionet e

tij subjektive dhe të forcës politike që përfaqëson, mbi faktet e konstatuara.

Lidhur me çështjen nëse i padituri ka tejkaluar lirinë e shprehjes në dëm të nderi dhe personalitetit të paditësit, gjykata e apelit mban në vëmendje si ato pjesë të deklaratës ku përmendet emri i këtij të fundit, ashtu edhe qëllimin që ka pasur i padituri në përfshirjen e opinionëve mbi dyshimet e tij për abuzim me privatizimin e Kompleksit Sportiv “Partizani”. Rezulton se për rastin e privatizimit të kësaj prone, i padituri ndër të tjera u është referuar si zhvillimeve të kuadrit ligjor të kryera gjatë qeverisjes së Kryeministrit Sali Berisha (vjuhërr i paditësit), ashtu edhe indicieve të vlerësuara prej tij si të rëndësishme, për të krijuar perceptimin se ky rast përbën abuzim dhe se ish-pronarët përfshirë edhe paditësin janë favorizuar pikërisht për shkak të lidhjes së ngushtë familjare mes paditësit dhe Kryeministrit. Ashtu si është referuar në përshkrimin e fakteve, pretendimeve dhe provave, i padituri i është referuar një informacioni të dërguar Presidentit të Republikës, nga Komandanti i Komandës Mbështetëse të FA, nga përmbajtja e të cilit rezulton se këtij të fundit i është kërkuar në mënyrë permanente nënshkrimi i kontratës së shitjes së Kompleksit Sportiv “Partizani”, ndonëse ai e konsideronte këtë të paligjshme. Po ashtu, në këtë informacion ku shprehet shqetësimi i Ushtarakut Madhor, bëhet me dije se për këtë çështje është ushtruar një kontroll me urdhër të Kryeministrit dhe më pas, atij i është kërkuar sërish nënshkrimi i kontratës. Ky dokument, shoqëruar me bërjen publike të fakteve të pakundërshtuara nga paditësi dhe as nga autoritetet shtetërore, lidhur me mundësimin e privatizimit, vetëm pas ndryshimit të Ministrit të Mbrojtjes dhe Komandantit të Komandës Mbështetëse, si dhe ngritjen në karrierë të këtij të fundit, që bëri të mundur lidhjen e kontratës, vlerësohen si rrethana të arsyeshme, për të cilat një politikan kundërshtar i Kryeministrit dhe anëtar i partisë në opozitë, të shtrojë për diskutim në publik rregullshmërinë e procesit të privatizimit dhe abuzimet e kryera në kuadër të tij.

Gjykata e apelit duke mbajtur në vëmendje jurisprudencën e GJEDNJ për raste analoge, vlerëson se i padituri në cilësinë

e deputetit të opozitës ka lirinë e shprehjes së opinioneve dhe gjykimeve të tij, madje duke lejuar deri diku edhe ndonjë tepri. Nga ana tjetër, pavarësisht se paditësi është ndierë i fyer në nderin dhe personalitetin e tij, kjo nuk mjafton për ta cilësuar veprimin e të paditurit si të kundërligjshëm.

Për sa më sipër, deklaratat e bëra nga i padituri dhe të cilësuar nga paditësi si shpifje, në gjykimin e gjykatës së apelit, nuk vlerësohen të tilla, për sa kohë që ato e kanë një bazë faktike për shkak të së cilës janë bërë publike dhe për sa kohë që nga Ministria e Mbrojtjes nuk rezulton të jetë sqaruar publiku me transparencë, lidhur me këtë shqetësim të ngritur nga i padituri si përfaqësues i Partisë Socialiste. Në cilësimin e veprimeve të të paditurit, gjykata e apelit, ndryshe nga ajo e shkallës së parë gjykon se qëllimi i vërtetë i të paditurit ka qenë shprehja e opinionit të tij dhe partisë që përfaqëson, lidhur me keq qeverisjen dhe posaçërisht mënyrës së administrimit të pasurive në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes në procesin e privatizimit të Kompleksit Sportiv “Partizani”.

Në këtë rast, gjykata e apelit e vlerëson pa vend arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas të cilit i padituri duhej t’i drejtohej prokurorisë për shkeljet e pretenduara. Ky qëndrim do të çonte në një situatë, në të cilën asnjë dyshim apo pretendim i politikanëve apo medias, për abuzime me pushtetin dhe kundërshtimet lidhur me mënyrën e veprimit të qeverisë, nuk do të duhej të bëheshin publike apo të shtroheshin për diskutim të gjerë, ndërkohë që si roli i politikanëve ashtu edhe ai i medias, në një shoqëri demokratike është ai i monitoruesit publik, bërjes së opozitës lidhur me qeverisjen dhe do të ishte e papranueshme që këto subjekte të privoheshin nga e drejta për të ndarë me publikun çështje të rëndësishme për të, vetëm nga fakti se nuk do bëhej e mundur të vërtetohej në detaje vërtetësia e deklarimeve. Në rastin konkret, nuk vërtetohet se gjykimet kritikuese të të paditurit nuk kanë asnjë bazë faktike dhe se qëllimi i tij ka qenë cenimi i nderit dhe personalitetit të paditësit.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme	X	
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

BEGEJA ETJ K. BALLA

Vendimi nr.11354, dt.13.11.2013

Deklarimet e të paditurit me cilësinë e deputetit në rastin konkret nuk janë shpifje apo trillime të tij me qëllim për të diskredituar paditësat. Nga ana tjetër ajo janë jashtë interesit vetiak. Me cilësinë e deputetit dhe në përmbushje të kësaj detyre ai ka shprehur mendime dhe opinione të bazuara në disa prova e fakte të vërteta. Thelbi i deklarimeve të tij ka të bëjë me mbrojtjen e pronës publike kundër abuzimeve dhe veprimeve të paligjshme nga institucionet e shtetit. Rrëzimi i padisë.

Faktet

Paditësit pretendojnë se i padituri, me detyrën deputet në Kuvendin e Shqipërisë, ka deklaruar fakte të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tyre, të cilat kanë fyer nderin dhe dinjitetin e paditësve. Kështu, i padituri, gjatë një konference për shtyp në ambjentet e Partisë Socialiste, me datë 9.10.2012 ka deklaruar se paditësit kanë përfutur një pasuri në mënyrë të padrejtë nga procesi i privatizimit të një prone shtetërore. Sipas deklaratave, privatizimi i objekteve publike është bërë në kundërshtim me ligjin, duke qenë se përfutuesi kryesor ka qenë bashkëshorti i vajzës së Kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha.

Paditësit pretendojnë se këto deklarata janë tërësisht të pavërteta dhe përbëjnë fyerje kundrejt tyre, pasi ata e kanë përfutur pronën sipas ligjit, duke qenë se kjo pronë u ishte shtetëzuar trashëgimlënësve të tyre nga regjimi komunist. Ata kishin marrë pjesë në procesin e privatizimit dhe si ish pronarë kanë përfutur të drejtën e parablerjes. Paditësit ndihen të cenuar në nderin dhe dinjitetin e tyre duke i akuzuar se kanë përfutur pronën e tyre në mënyrë të kundërligjshme. Ata kërkojnë dëmshpërblim financiar prej 10 milionë lekë nga i padituri.

I padituri prapësoi se këto deklarime i ka të mbështetura në prova dhe qëllimi nuk ka qenë denigrimi i pronarëve ose personave të caktuar por nxjerrja e të vërtetës dhe bërja publike e saj,

në funksion të rolit që ka deputeti. Ai si deputet nuk mund të mos shprehet kur vëren fakte paligjshmërie në privatizimin e pronave publike.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata ka vlerësuar njëkohësisht lirinë e shprehjes dhe dinjitetin personal. Sipas saj, liria e shprehjes prevalon, pasi ndihmon publikun të informohet. Gjykata vlerëson se Kushtetuta i ka dhënë mbrojtje të posaçme deputetit të Kuvendit me qëllim realizimin e detyrës së tij ndaj zgjedhësve. Deklarimet e të paditurit me cilësinë e deputetit në rastin konkret nuk janë shpifje apo trillime të tij me qëllim për të diskretituar paditësat. Nga ana tjetër ajo janë jashtë interesit vetiak. Me cilësinë e deputetit dhe në përmbushje të kësaj detyre ai ka shprehur mendime dhe opinione të bazuara në disa prova e fakte të vërteta. Thelbi i deklarimeve të tij ka të bëjë me mbrojtjen e pronës publike kundër abuzimeve dhe veprimeve të paligjshme nga institucionet e shtetit. Deputeti duhet të ketë mundësi të për të shfaqur hapur dhe i pacensuruar opinionet e tij, të cilat përbëjnë vullnet politik për të cilin është votëbesuar nga zgjedhësit. Kjo bëhet më e rëndësishme kur opinionet e tij drejtohen kundër dukurive negative. Gjykata vlerëson se i padituri nuk ka kryer veprime të kundërligjshme dhe me faj dhe as nuk ka përmendur emrat e paditësve prandaj padia rrëzohet.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë		X
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi	X	
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

SHOQËRIA TREGTARE STSA ALBANIA K. SHOQËRIA TREGTARE SHQIPTARJA.COM

Vendimi nr.2975, dt.1.12.2014 (çështje penale)

Deklarimet e të akuzuarit me cilësinë e një gazete nuk janë shpifje apo trillime të tij me qëllim për të diskretituar paditësat por me dhënien e informacionit ndaj publikut lidhur me aktivitetin e një organi publik dhe mbrojtjen e interesave shtetërore kundër abuzimeve dhe veprimeve të paligjshme nga institucionet e shtetit. Gjykata vlerëson se qëllimi i mbrojtjes së individit nga veprat e fyerjes dhe shpifjes nuk është mbrojtja e interesave ekonomike dhe pasurore të personit por janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar dinjitetin e personit apo emrin e mire dhe reputacionin e personit juridik, si të drejta jopasurore. Deklarimi i pafajshëm.

Faktet

Paditësi pretendon se i padituri, në një artikull të botuar në gazetën e tij, ka fyer dhe shpifur ndaj tij duke mashtruar opinionin publik me faktin se kompania STS Albania ka marrë përqindjen e saj financiare në një negociim të fshehtë me qëllim blerjen e pajisjeve të sigurisë për Shërbimin Informativ të Ushtrisë. Sipas tij, i padituri nuk paraqet asnjë fakt dhe provë të besueshme.

I padituri prapësoi duke deklaruar se organi i saj ku është botuar artikulli është një gazete e pavarur dhe prestigjioze. Të dhënat e publikuara kanë patur si burim SHIU dhe gazeta vetëm sa ka përcjellë informacionin dhe nuk ka patur asnjë qëllim të fyejë apo shpifë ndaj askujt.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se i akuzuari është person juridik, botues i një gazete që ka për veprimtari kryesore informimin e publikut. Në artikullin mbi të cilin mbështetet akuza bëhet fjalë për informim të publikut mbi procedurën e tenderimit të një organi

publik, SHIU. I dëmtuari akuzues ka qenë në rolin e shoqërisë ndërmjetësuese dhe si e tillë është përmendur në artikull. Pra qëllimi nuk ka qenë fyerja ose goditja e të dëmtuarit, por transparenca e veprimtarisë së organit publik.

Gjykata nuk konstaton asnjë fjalë apo paragraf fyes ndaj shoqërisë STS Albania. Gjithashtu, mungon edhe elementi i anës subjektive të figurës së veprës penale të fyerjes, e cila kërkon dashjen direkte si dhe qëllimin e posaçëm, cenimin e ndjenjës së dinjitetit të personit. Sa i takon pretendimit të akuzuesit se fyerja dhe shpifja ndaj tij kanë sjellë si pasojë dëmtimin e interesave ekonomike, Gjykata vlerëson se qëllimi i mbrojtjes së individit nga veprat e fyerjes dhe shpifjes nuk është mbrojtja e interesave ekonomike dhe pasurore të personit por janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar dinjitetin e personit apo emrin e mirë dhe reputacionin e personit juridik, si të drejta jopasurore.

Gjykata vlerëson se barra e provës i takon kërkuesit (i dëmtuari akuzues), i cili nuk arriti të provojë të gjithë elementët e veprës penale për të cilat akuzon palën akuzuese. Gjykata vlerëson se pala e akuzuar nuk ka kryer veprime të kundërligjshme me faj në dëm të akuzuesit për rrjedhojë deklarohet pafajësia e të akuzuarit.

SHOQËRIA “BELLA CONFEX” SHPK, BAZHDARI K. ZYRA PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT, GOXHAJ

Vendimi nr.570, dt.24.03.2014 (penale)

Investimi i gjykatës, bazuar në nenin 59 të KPP, është një e drejtë tërësisht e të dëmtuarit akuzues dhe kusht themelor për zhvillimin e gjykimit. Është gjithashtu detyrimi i të dëmtuarit akuzues të paraqesë provat mbi të cilat mbështet akuzën e ngritur. Ndërsa i akuzuari prezumohet i pafajshëm derisa të provohet e kundërta nga i dëmtuari akuzues. Deklarimi fajtor vetëm i personit fizik.

Faktet

I dëmtuari akuzues është shpk me objekt prodhim tegetim konfeksione, me administratore të dëmtuarën Bazhdari. I akuzuari është administrator i Zyrës për Mbrojtjen e Konsumentit. Ky i fundit ka organizuar në rrjetet sociale një fushatë kundër të dëmtuarit akuzues lidhur me menyrat jo etike deri deri kriminale të reklamimit të produkteve që ajo prodhon dhe tregton. Sipas tij, pamjet në foto paraqesin materiale me pamje të fëmijëve minorenë që modelojnë me veshje intime, sipas tij, të karakterit pedofilik.

I dëmtuari akuzues parashtron se këto deklarata janë shpifje me qëllime kriminale, nisur nga prapavija politike. Fëmijët që janë marrë për reklamimin e produkteve të saj janë të afërm të familjes së të dëmtuarit akuzues dhe prindërve të tyre u është marrë leje dhe vetë fëmijëve u është marrë pëlqimi.

I akuzuari kërkoi deklarimin të pafajshëm, pasi nuk ka konsumuar asnjë element të veprës penale të shpifjes. Faqja e interentit mund të jetë piratuar edhe nga të tjerë.

Prokuroria mbajti qëndrimin se i akuzuari ka konsumuar plotësisht elementët e veprës penale të shpifjes dhe duhet të dënohet me 100.000 lekë gjobë.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se personi juridik Zyra për Mbrojtjen e Qytetarit nuk rezulton të ketë kryer veprën penale të shpifjes, pasi për këtë nuku sollën prova. Ndërsa për të akuzuarin tjetër Goxhaj, gjykata krijoi bindjen se ka kryer të gjitha elementët e veprës penale të shpifjes me qëllim cenimin e nderit dhe të dinjitetit të të dëmtuarit akuzues. I akuzuari nuk ka kërkuar as ndjesë publike duke refuzuar edhe paraqitjen në gjykatë. Nisur edhe nga provat dhe dëshmitarët e thirrur në gjykim, gjykata vendosi deklarinimin fajtor të të akuzuarit Goxhaj dhe dënimin e tij me 90.000 lekë gjobë.

JANI K. SELAMAJ

Vendimi nr.1249, dt.21.09.2012 (penale)

Nuk u vërtetua nga e dëmtuara akuzuese asnjë element i veprës penale të fyerjes nga ana e të akuzuarës. Deklarim i pafajshëm.

Faktet

E dëmtuara akuzuese ka paraqitur kërkesën me objekt akuzën penale të fyerjes ndaj të akuzuarës. Ato punojnë bashkë në pozicione të ndryshme pune. E dëmtuara akuzuese parashtron se nga ana e të akuzuarës është fyer rëndë.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se duke mbajtur parasysh elementët e veprës penale në gjykim nuk u vërtetua se e akuzuara të ketë kryer veprime, me gjepte apo me fjalë poshtëruese që të kenë cenuar rëndë dinjitetin dhe personalitetin e saj. Gjykata vendosi deklarin e pafajshëm të të akuzuarës.

MALLTEZI, BERISHA K. TAHIRI

Vendimi nr. 3011, dt.21.12.2012 (Gjykata e Apelit)

Në gjykimin civil dhe të drejtën e detyrimeve në dallim nga e drejta penale, vlen parimi i prezumimit të fajësisë. Paditësi ka detyrimin vetëm të provojë deklaratimet e të paditurit që i kanë cenuar nderin dhe personalitetin e pastaj barra e provës për të provuar faktet që qëndrojnë në bazë të deklarimeve bien mbi palën e paditur. Për të provuar ekzistencën e këtij dëmi, mjafton edhe vetëm fakti i paraqitjes së padisë në gjykatë gjë që provon se cenim i botës së brendshme të paditësit e ka detyruar atë t'i drejtohet me padi gjykatës për të rivendosur në vend të drejtën e cenuar. Liria e shprehjes dubet ushtruar duke respektuar edhe të drejtën për jetë private. Neni 73 i Kushtetutës nuk e mbron deputetin ndaj çdo lloji deklaratë, sidomos kur nuk është bërë në ambiente të Kuvendit apo në funksion të detyrës së tij si i tillë.

Fakti që paditësit kanë të ardhura të konsiderueshme nuk mund t'u mohojë atyre të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim për dëmin jopasuror. Morali dhe dinjiteti i personit nuk ka çmim dhe nuk ka formulë llogaritëse, por gjykata në caktimin e saj niset nga kritere dhe praktika tashmë të konsoliduara. Lënien në fuqi të vendimit.

Faktet

Paditësit, fëmijët e kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha, pretendojnë se i padituri, me detyrën deputet në Kuvendin e Shqipërisë, ka deklaruar fakte të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tyre, të cilat kanë fyer nderin dhe personalitetin e paditësve. Deklaratat konsistojnë në akuza për përfshirje në afera korruptive dhe të dyshimta të paditësve për shkak të qenies së tyre familjarë të ngushtë të Kryeministrit. Faktet korruptive, sipas të paditurit, i referohen çështjeve që lidhen me kompleksin energjitik në Porto Romano dhe me çështjen e tragjedisë së Gërdecit. Këto deklarata janë bërë në një emision televiz me shikueshmëri të lartë.

Paditësit pretendojnë se këto deklarata janë tërësisht të pavërteta dhe përbëjnë fyerje kundrejt tyre duke cenuar nderin dhe

personalitetin e tyre. Ata kërkojnë dëmshpërblim moral dhe përgënjeshttrim të tyre nga i padituri, i cili ka vepruar me faj me qëllim denigrimin e figurës së tyre në publik.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur: “Pranimin e padisë dhe dëmshpërblimin e të paditurve me shumën prej 2.500.000 leke secilin.”

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim i padituri, i cili ka parashtruar se gjykata e rrethit nuk ka kryer hetim të plotë dhe ka zbatuar keq ligjin duke caktuar një masë të papërshtatshme të dëmshpërblimit. Materiali filmik nuk i është nënshtruar debatit gjyqësor.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vlerëson se vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor është i bazuar në ligj dhe prova. Ajo me të drejtë ka konstatuar se i padituri është një subjekt që ka një mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta lidhur me lirinë e shprehjes (neni 73 i Kushtetutës). Funkzioni dhe detyra e deputetit lidhet mjaft ngushtë me pushtetin të cilit ai i përket. Megjithatë deklaratat e palës së paditur nuk mund të gjejnë mbrojtje nga neni 73 i Kushtetutës, pasi: së pari deklaratat nuk janë bërë në ambjentet e Kuvendit ose të tjera të barazuara me të. Ato nuk ishin as riprodhim i deklaratave të bërë gjatë punimeve të Kuvendit. Ato janë bërë në një emision televiz duke përmendur emrat e paditësve qëllimisht. Së dyti, nuk është në misionin e deputetit të bëjë akuza publike për fakte konkrete. Ai mund të denoncojë në organet e prokurorisë pasi të ketë bërë kallëzim sipas rregullave procedurale. Së treti, pohimet e palës së paditur nuk u provuan të ishin të vërteta. I padituri, nisur nga funksioni që ka dhe në emër të interesit publik nuk mund të disinformojë apo të cenojë me qëllim individët pa respektuar parime të së drejtës të tilla si prezumimi i pafajsisë apo barrën e provës për akuzat që ngrenë.

Gjykata çmon se duhet mbajtur një balancë e drejtë midis lirisë së shprehjes dhe të drejtës për jetë private. Në këtë kuptim, liria e shprehjes së deputetit nuk mund të prevalojë ndaj jetës private të dy personave që nuk janë funksionarë. Nga i paditu-

ri nuk u soll asnjë provë për të vërtetuar thëniet e tij. Gjykata vlerëson 4 elementët e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktura paditësit. Kundërligjshmëria e veprimeve të të paditurit prezumohet pasi ai nuk solli prova të vërtetonte pretendimin e tij për faktet që përmban deklarata. Ai i ka mbështetur ato në fjalë dhe thënie të pavërteta duke cenuar nderin dhe dinjitetin e paditësve. Këta të fundit janë cenuar në dinjitetin e tyre, duke qenë se ata janë persona të respektuar në shoqëri dhe profesion për shkak të angazhimit të tyre profesional. Duke bërë publike thënie të pavërteta, atyre u është shkaktuar dëm i rëndë. Lidhur me fajësinë, ajo konstaton se i padituri në rolin e tij si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ka vepruar me faj në formën e dashjes për shkak se e dinte dhe mund të parashikonte se përdorimi i deklaratave të pabaza, në drejtim të paditësve do të shkaktonte dëm në nderin dhe personalitetin e tyre. I padituri nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën. Po ashtu vërtetohet edhe lidhja shkakësore midis veprimit të paligjshëm dhe dëmit të shkaktuar.

Sa i takon masës së dëmshpërblimit, Gjykata vlerëson se duke marrë në tërësi faktet e parashtruara si dhe deklarin e paditësve se kërkimet e tyre nuk kanë për synim përfitimin e një dëmshpërblimi sa më të madh si dhe duke u nisur nga niveli ekonomik në tërësi në vend, e sheh me vend të ndryshojë masën e dëmshpërblimit nga 2.500.000 lekë për secilin paditës në 1.000.000 lekë. Kjo konsiderohet si shumë e arsyeshme duke mbajtur parasysh: ciësitë e paditësve dhe të të paditurit, rëndesën e akuzave, personalitetin social të paditësit, pozitën e të paditurit, mënyrën e përhapjes së thënieve (nëpërmjet televizionit), mundësinë e të paditurit për të përgënjeshtuar thëniet, pagën e të paditurit. Për këto arsye, lihet në fuqi vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor me ndryshimin e shumës së dëmshpëblimit.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve		X
3	Format dhe shkallën e fajësisë	X	
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar	X	
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		x
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit	X	

KOKËDHIMA K. BERISHËS

Vendimi nr.1959, dt.19.07.2012 (Gjykata e Apelit)

Liria e shprehjes së të paditurit në Kuvend dhe si kryeministër është mjeti kryesor i politikbërjes dhe kjo është e rëndësishme për përfaqësuesit publikë të zgjedhur.

Deklaratat e bëra nuk duhen marrë të shkëputura por duhen analizuar në tërësi. Një fjalë apo shprehje e përdorur në një deklaratë nuk mund të marrë kuptimin e plotë dhe të vërtetë të saj e shkëputur nga shprehjet e tjera. Një shkëputje e tillë krijon një ide të përciptë dhe të pasaktë mbi përmbajtjen e vërtetë të fjalës. Lënien në fuqi të vendimit (rëzimi i padisë).

Faktet

Paditësi pretendon se i padituri me detyrën deputet në Kuvendin e Shqipërisë, ka deklaruar fakte të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tij, të cilat kanë fyer nderin dhe dinjitetin e paditësit. Deklaratat e përsëritura konsistojnë në akuza për përfitime në kundërshtim me ligjin, bazuar në lidhjet e paditësit me kryetarin e bashkisë Tiranë (njëkohësisht edhe kryetarin e opozitës) dhe ndikimin e tij në botën e biznesit. Këto deklarata i kanë shkaktuar përveç cenimit të dinjitetit edhe dëm të madh moral pasi është sipërmarrës i njohur në vend. Ai kërkon dëmshpërblim moral dhe përgënjeshttrim të tyre nga i padituri..

I padituri ka pretenduar se deklaratat e tij nuk përbëjnë fyerje dhe shpifje dhe kjo gjë është vërtetuar nga gjykata. Thëniet nuk janë të pavërteta, është fakt që paditësi ka lidhje me kryetarin e bashkisë Tiranë dhe se detyra e një politikani, siç është i padituri është të dekarojë dhe bëjë publike fenomene negative që janë në dëm të interesave të qytetarëve.

Paditësi i është drejtuar gjykatë së rrethit gjyqësor me padinë për detyrimin e të paditurit për të përgënjeshtuar deklaratat fyese dhe shpifëse dhe dëmshpërblimin e dëmit jopasuror 10.000.000 lekë. Gjykata e rrethit ka vendosur rrëzimin e padisë.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata e Apelit vlerëson se i padituri i ka bërë deklaratat në dy ambiente, në Kuvendin e Shqipërisë, si deputet, dhe në Kryeministri, si kryeministër. Liria e shprehjes së të paditurit në Kuvend dhe si kryeministër është mjeti kryesor i politikbërjes dhe kjo është e rëndësishme për përfaqësuesit publikë të zgjedhur.

Deklaratat e bëra nuk duhen marrë të shkëputura por duhen analizuar në tërësi. Një fjalë apo shprehje e përdorur në një deklaratë nuk mund të marrë kuptimin e plotë dhe të vërtetë të saj e shkëputur nga shprehjet e tjera. Një shkëputje e tillë krijon një ide të përciptë dhe të pasaktë mbi përmbajtjen e vërtetë të fjalës. Në asnjë nga deklaratat e të paditurit nuk ka qenë paditësi objekt i deklaratës, as cilësitë e tij fizike personale dhe as veprimtaria e tij tregtare, por qëndrimi i opozitës ndaj procesit zgjedhor dhe rezultati zgjedhor. Pra, mungon qëllimi për të goditur personalisht të paditurin. Gjatë gjykimit nuk rezultoi se të dhënat e përmendura në deklaratë të jenë të falsifikuara. Në këto kushte, nuk ka vend për të pranuar padinë.

Nr	Faktorët specifikë që duhet të merren parasysh nga gjykata në përcaktimin e përgjegjësisë	Po	Jo
1	Mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve	X	
2	Shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve	X	
3	Format dhe shkallën e fajësisë		X
4	Faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë		X
5	Faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit	X	
6	Faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik	X	
7	Faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme		X
8	Faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje	X	
9	Kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtërimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar		X
10	Faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi		X
11	Faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit		X

KOKËDHIMA K. BERISHËS

Vendimi nr.7, dt.07.06.2010 (Kolegji Penal i GJL)

Liria e shprehjes së të paditurit në Kuvend dhe si kryeministër është mjeti kryesor i politikbërjes dhe kjo është e rëndësishme për përfaqësuesit publikë të zgjedhur. Deputeti nuk mund të procedohet penalisht për mendimet e shprehura në seancat parlamentare dhe jashtë tyre. Dispozita për shpifjen nuk mbron njerëzit nga një gjubë që është thjesht ofenduese ose tronditëse ose për shprehjen e opinionit. Nga leximi i plotë i deklaratave objekt shqyrtimi, konstatohet se ato janë trajtuar jashtë kontekstit dhe argumentet e përdorura janë trajtuar në mënyrë të copëzuara. Ato në asnjë rast nuk i janë drejtuar të dëmtuarit akuzues por kundërshtarit të tij politik. Pushimi i çështjes.

Faktet

I dëmtuari akuzues pretendon se i akuzuari me funksionin deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe Kryeministër, në ambjentet e Kuvendit (në datë 26.11.2009) dhe në konferencë për shtyp (në datat 02.07.2010 dhe 02.12.2009) ka deklaruar fakte të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tij, të cilat kanë fyer nderin dhe dinjitetin e të dëmtuarit akuzues. Deklaratat e përsëritura konsistojnë në akuza për manipulim të zgjedhjeve parlamentare nëpërmjet mjeteve të paligjshme. Këto deklarata i kanë shkaktuar përveç cenimit të dinjitetit edhe dëm të madh moral pasi është sipërmarrës i njohur në vend. Ai kërkon dënimin e të akuzuarit për veprën penale të fyerjes dhe shpifjes.

I akuzuari ka pretenduar se deklaratat e tij nuk përbëjnë fyerje dhe shpifje. Thëniet nuk janë të pavërteta. I akuzuari në rolin e kryeministrit të vendit ka detyrë të informojë publikun për dukuri të paligjshme dhe abuzime me pushtetin, qoftë edhe nga njerëz që ushtrojnë veprimtari jashtë strukturave shtetërore. I akuzuari i ka bërë deklaratat në kushtet e nenit 73 të Kushtetutës.

Vlerësimi i Gjykatës

Kolegji Penal vlerëson se çështja penale ndaj të akuzuarit duhet të pushohet, pasi ndodhet në kushtet e nenit 73/1 të kushtetutës dhe neneve 290 dhe 387 të KPP. I akuzuari i ka bërë deklaratat në dy ambiente, në Kuvendin e Shqipërisë, si deputet, dhe si kryeministër në konferenca për shtyp. Liria e shprehjes së të paditurit në Kuvend dhe si kryeministër është mjeti kryesor i politikbërjes dhe kjo është e rëndësishme për përfaqësuesit publikë të zgjedhur. Deputeti nuk mund të procedohet penalisht për mendimet e shprehura në seancat parlamentare dhe jashtë tyre. Kolegji bazohet edhe tek nenet 22, 23 të Kushtetutës që garantojnë lirinë e shprehjes. Në kushtet e një demokracie politike efektive dhe të respektimit të të drejtave të njeriut, liria e shprehjes nuk mbart rëndësi vetëm në vetvete por gjithashtu ajo luan një rol kryesor në mbrojtje e të drejtave të njeriut. Nuk ka vend të lirë dhe as demokraci pa një garantim të gjerë të së drejtës për lirinë e shprehjes. Liria e shprehjes është një e drejtë themelore e njeriut për vetë rolin e saj në demokraci.

Në rastin në shqyrtim deklaratimet janë në kuadër të përmbushjes së detyrave parlamentare si përfaqësues i popullit në një situatë të rënduar politike kur komunikimi me opozitën dhe drejtuesit e saj nuk mund të bëhej në parlament. Kolegji nuk e sheh me vend të kërkojë nga Kuvendi autorizim për procedim penal ndaj të akuzuarit, pasi ai nuk duhet të mbajë përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe jashtë sallës së tij. Ai nuk mund të jetë subjekt i veprës penale të fyerjes, pasi mbrohet nga neni 73/1 i Kushtetutës dhe neni 10 i KEDNJ. Dispozita për shpifjen nuk mbron njerëzit nga një gjuhë që është thjesht ofenduese ose tronditëse ose për shprehjen e opinionit. Nga leximi i plotë i deklaratave objekt shqyrtimi, konstatohet se ato janë trajtuar jashtë kontekstit dhe argumentet e përdorura janë trajtuar në mënyrë të copëzuar. Ato në asnjë rast nuk i janë drejtuar të dëmtuarit akuzues por kundërshtarit të tij politik.

Kolegji vlerëson se i dëmtuari nuk arriti të paraqiste prova se i akuzuari ka përhapur thënie apo informacione të rreme me

qëllim cenimin e dinjitetit të tij. Gjithashtu, i dëmtuari nuk paraqiti prova që i akuzuari kishte dijeni publike se thëniet janë të rreme. Në këto kushte u vendos pushimi i çështjes.

PEZA K. BERISHËS

Vendimi nr.11, dt.20.01.2012 (Kolegji Penal i GJL)

Liria e shprehjes së të paditurit në Kuvend dhe si kryeministër është mjeti kryesor i politikbërjes dhe kjo është e rëndësishme për përfaqësuesit publikë të zgjedhur. Deputeti nuk mund të procedohet penalisht për mendimet e shprehura në seancat parlamentare dhe jashtë tyre. Dispozita për shpifjen nuk mbron njerëzit nga një gjubë që është thjesht ofenduese ose tronditëse ose për shprehjen e opinionit. Nga leximi i plotë i deklaratave objekt shqyrtimi, konstatohet se ato janë trajtuar jashtë kontekstit dhe argumentet e përdorura janë trajtuar në mënyrë të copëzuar. Ato në asnjë rast nuk i janë drejtuar të dëmtuarit akuzues por kundërshtarit të tij politik. Pushimi i çështjes.

Faktet

I dëmtuari akuzues, deputet në Kuvendin e Shqipërisë, pretendon se i akuzuari me funksionin deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe Kryeministër, në seancën plenare të datës 26.11.2009 në Kuvend ka përhapur qëllimisht thënie të rreme, të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tij dhe bashkëshortes së tij, të cilat kanë fyer nderin dhe dinjitetin e të dëmtuarit akuzues dhe familjes së tij. Deklaratat e përsëritura konsistojnë në akuza për mënyrë jetese të pamoralshme. Këto deklarata i kanë shkaktuar përveç cenimit të dinjitetit edhe dëm të madh moral për të dhe familjen e tij. Ai kërkon dënimin e të akuzuarit për veprën penale të fyerjes dhe shpifjes.

I akuzuari ka pretenduar se deklaratat e tij nuk përbëjnë fyerje dhe shpifje. Thëniet nuk janë të pavërteta dhe ato nuk i drejtohen të dëmtuarit akuzues por një personi të tretëm konkretisht kryetarit të opozitës. I akuzuari në rolin e kryeministrit të vendit ka detyrë të informojë publikun për dukuri të pamorlashme të njerëzve me pushtet. Ai gjithashtu, parashtroi se deklaratat e tij janë deformuar duke shtuar fjalë dhe shprehje.

Vlerësimi i Gjykatës

Kolegji Penal vlerëson se procedimi penal ndaj të akuzuarit nuk duhet të fillojë, pasi ndodhet në kushtet e nenit 73/1 të kushtetutës dhe neneve 290 dhe 387 të KPP. I akuzuari i ka bërë deklaratat në Kuvendin e Shqipërisë, si deputet, dhe si kryeministër. Liria e shprehjes së të paditurit në Kuvend dhe si kryeministër është mjeti kryesor i politikbërjes dhe kjo është e rëndësishme për përfaqësuesit publikë të zgjedhur. Deputeti nuk mund të procedohet penalisht për mendimet e shprehura në seancat parlamentare dhe jashtë tyre. Në kushtet e një demokracie politike efektive dhe të respektimit të të drejtave të njeriut, liria e shprehjes nuk mbart rëndësi vetëm në vetvete por gjithashtu ajo luan një rol kryesor në mbrojtje e të drejtave të njeriut. Nuk ka vend të lirë dhe as demokraci pa një garantim të gjerë të së drejtës për lirinë e shprehjes. Liria e shprehjes është një e drejtë themelore e njeriut për vetë rolin e saj në demokraci.

Në rastin në shqyrtim deklarimet i janë drejtuar kryetarit të opozitës dhe jo të dëmtuarit. Personat e tjerë të përmendur nuk kanë qenë qëllimi i vërtetë i deklaratave. Kolegji vlerësoi se duke qenë se barra e provës i takon të dëmtuarit akuzues, pasi e kundërta do të kishte efekt frenues për lirinë e shprehjes, nuk u paraqit asnjë provë prej tyre që të vërtetojë se i akuzuari ka përhapur thënie ose informacione të rreme me qëllim cenimin e dinjitetit të të dëmtuarve akuzues. Kolegji vëren se për të njëjtin fakt dhe ligjëratë të fjalës së deputetit Berisha në seancën plenare të datës 26.11.2009 shtetasi Edi Rama, me cilësinë e kryetarit të PS ka paraqitur kallëzim në prokurori kundër të akuzuarit Berisha. Prokuroria ka vendosur mosfillimin e njëkjes penale me arsyetimin se “deklaratat janë pjesë e debatit politik dhe me interes publik. Këto deklarata janë opinione dhe gjykime vlerësuese brenda të njëjtit kuadër duke mos bërë të mundur që ato të fromojnë elementë të veprës penale të shpifjes për shkak të detyrës. Kolegji Penal i GJL, me vendimin nr.8, datë 01.07.2011 ka vendosur “mospranimin e ankimit të kallëzuesit Edi Rama ndaj vendimit të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal.”

Kolegji Penal i referohet praktikës së GJL, e cila ka shkuar në drejtim të shtrirjes së imunitetit parlamentar në lidhje me përgjegjshmërinë e deputeti për mendimet e shprehura edhe jashtë mjediseve të Kuvendit. Në këtë kuadër, Kolegji nuk e sheh me vend të kërkojë nga Kuvendi autorizim për procedim penal ndaj të akuzuarit, pasi ai nuk duhet të mbajë përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe jashtë sallës së tij. Ai nuk mund të jetë subjekt i veprës penale të fyerjes, pasi mbrohet nga neni 73/1 i Kushtetutës dhe neni 10 i KEDNJ. Dispozita për shpifjen nuk mbron njerëzit nga një gjuhë që është thjesht ofenduese ose tronditëse ose për shprehjen e opinionit. Nga leximi i plotë i deklaratave objekt shqyrtimi, konstatohet se ato janë trajtuar jashtë kontekstit dhe argumentet e përdorura janë trajtuar në mënyrë të copëzuar. Ato në asnjë rast nuk i janë drejtuar të dëmtuarit akuzues por kundërshtarit të tij politik.

Kolegji vlerëson se i dëmtuari nuk arriti të paraqiste prova se i akuzuari ka përhapur thënie apo informacione të rreme me qëllim cenimin e dinjitetit të tij. Gjithashtu, i dëmtuari nuk paraqiti prova që i akuzuari kishte dijeni publike se thëniet janë të rreme. Në këto kushte u vendos mosfillimi i procedimit penal.

RAMA K. BERISHËS

Vendimi nr.8, dt.01.07.2011 (Kolegji Penal i GJL)

Liria e shprehjes së të paditurit në Kuvend dhe si kryeministër është mjeti kryesor i politikbërjes dhe kjo është e rëndësishme për përfaqësuesit publikë të zgjedhur. Deputeti nuk mund të procedohet penalisht për mendimet e shprehura në seancat parlamentare dhe jashtë tyre. Dispozita për shpifjen nuk mbron njerëzit nga një gjubë që është thjesht ofenduese ose tronditëse ose për shprehjen e opinionit. Nga leximi i plotë i deklaratave objekt shqyrtimi, konstatohet se ato janë trajtuar jashtë kontekstit dhe argumentet e përdorura janë trajtuar në mënyrë të copëzuar. Ato në asnjë rast nuk i janë drejtuar të dëmtuarit akuzues por kundërshtarit të tij politik. Pushimi i çështjes.

Faktet

I dëmtuari akuzues, Edi Rama, ka paraqitur ankim për anulimin e vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme për mosfillimin e procedimit penal ndaj të akuzuarit, Sali Berisha me funksionin deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe Kryeministër, për veprën penale të shpifjes dhe fyerjes për shkak të detyrës. Në seancën plenare të datës 26.11.2009 në Kuvend ka përhapur qëllimisht thënie të rreme, të pavërteta dhe shpifje në drejtim të tij dhe bashkëshortes së tij, të cilat kanë fyer nderin dhe dinjitetin e të dëmtuarit akuzues dhe familjes së tij. Deklaratat e përsëritura konsistojnë në akuza për mënyrë jetese të pamoralshme. Këto deklarata i kanë shkaktuar përveç cenimit të dinjitetit edhe dëm të madh moral për të dhe familjen e tij. Ai kërkon dënimin e të akuzuarit për veprën penale të fyerjes dhe shpifjes.

I akuzuari ka pretenduar se deklaratat e tij nuk përbëjnë fyerje dhe shpifje. Thëniet nuk janë të pavërteta dhe ato nuk i drejtohen të dëmtuarit akuzues por një personi të tretëm konkretisht kryetarit të opozitës. I akuzuari në rolin e kryeministrit të vendit ka detyrë të informojë publikun për dukuri të

ptomorlashme të njerëzve me pushtet. Ai gjithashtu, parashtroi se deklaratat e tij janë deformuar duke shtuar fjalë dhe shprehje.

Vlerësimi i Gjykatës

Kolegji Penal vlerëson se procedimi penal ndaj të akuzuarit nuk duhet të fillojë, pasi ndodhet në kushtet e nenit 73/1 të kushtetutës dhe neneve 290 dhe 387 të KPP. I akuzuari i ka bërë deklaratat në Kuvendin e Shqipërisë, si deputet, dhe si kryeministër. Liria e shprehjes së të paditurit në Kuvend dhe si kryeministër është mjeti kryesor i politikbërjes dhe kjo është e rëndësishme për përfaqësuesit publikë të zgjedhur. Deputeti nuk mund të procedohet penalisht për mendimet e shprehura në seancat parlamentare dhe jashtë tyre. Në kushtet e një demokracie politike efektive dhe të respektimit të të drejtave të njeriut, liria e shprehjes nuk mbart rëndësi vetëm në vetvete por gjithashtu ajo luan një rol kryesor në mbrojtje e të drejtave të njeriut. Nuk ka vend të lirë dhe as demokraci pa një garantim të gjerë të së drejtës për lirinë e shprehjes. Liria e shprehjes është një e drejtë themelore e njeriut për vetë rolin e saj në demokraci.

Në rastin në shqyrtim deklaratimet i janë drejtuar kryetarit të opozitës dhe jo të dëmtuarit. Personat e tjerë të përmendur nuk kanë qenë qëllimi i vërtetë i deklaratave. Kolegji vlerësoi se duke qenë se barra e provës i takon të dëmtuarit akuzues, pasi e kundërta do të kishte efekt frenues për lirinë e shprehjes, nuk u paraqit asnjë provë prej tyre që të vërtetojë se i akuzuari ka përhapur thënie ose informacione të rreme me qëllim cenimin e dinjitetit të të dëmtuarve akuzues. Kolegji vëren se për të njëjtin fakt dhe ligjëratë të fjalës së deputetit Berisha në seancën plenare të datës 26.11.2009 shtetasi Edi Rama, me cilësinë e kryetarit të PS ka paraqitur kallëzim në prokurori kundër të akuzuarit Berisha. Prokuroria ka vendosur mosfillimin e njëkjes penale me arsyetimin se “deklaratat janë pjesë e debatit politik dhe me interes publik. Këto deklarata janë opinione dhe gjykime vlerësuese brenda të njëjtit kuadër duke mos bërë të mundur që ato të fromojnë elementë të veprës penale të shpifjes për shkak të detyrës. Kolegji Penal i GJL, me vendimin nr.8, datë 01.07.2011

ka vendosur “mospranimin e ankimit të kallëzuesit Edi Rama ndaj vendimit të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal.”

Kolegji Penal i referohet praktikës së GJL, e cila ka shkuar në drejtim të shtrirjes së imunitetit parlamentar në lidhje me papërgjegjshmërinë e deputeti për mendimet e shprehura edhe jashtë mjediseve të Kuvendit. Në këtë kuadër, Kolegji nuk e sheh me vend të kërkojë nga Kuvendi autorizim për procedim penal ndaj të akuzuarit, pasi ai nuk duhet të mbajë përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe jashtë sallës së tij. Ai nuk mund të jetë subjekt i veprës penale të fyerjes, pasi mbrohet nga neni 73/1 i Kushtetutës dhe neni 10 i KEDNJ. Dispozita për shpifjen nuk mbron njerëzit nga një gjuhë që është thjesht ofenduese ose tronditëse ose për shprehjen e opinionit. Nga leximi i plotë i deklaratave objekt shqyrtimi, konstatohet se ato janë trajtuar jashtë kontekstit dhe argumentet e përdorura janë trajtuar në mënyrë të copëzuar. Ato në asnjë rast nuk i janë drejtuar të dëmtuarit akuzues por kundërshtarit të tij politik.

Kolegji vlerëson se i dëmtuari nuk arriti të paraqiste prova se i akuzuari ka përhapur thënie apo informacione të rreme me qëllim cenimin e dinjitetit të tij. Gjithashtu, i dëmtuari nuk paraqiti prova që i akuzuari kishte dijeni publike se thëniet janë të rreme. Në këto kushte u vendos mosfillimi i procedimit penal.

DËMSHPERBLIMET E DHËNA NGA GJYKATA NË ÇËSHTJET E DEFAMACIONI

Nr.	Emri i çështjes	Masa e dëmshpërblimit e dhënë nga gjykata
1	Tuci k. Shoqeria Standard shpk Vendimi nr.6187, dt. 04.6.2013	-
2	Olldashi k. Bollino, Basha dhe Murati Vendimi nr.5694, dt. 23.05.2013	75.000 Euro
3	Shehu k. Xh.Peza dhe Sh.Peza Vendimi nr.5311, dt. 14.05.2013	-
4	Berisha k. Balla Vendimi nr.5245, dt. 13.05.2013	-
5	Skeja k. Deda Vendimi nr.4651, dt. 29.04.2013	99.999 lekë.
6	Veliaj k. Goxhaj Vendimi nr.1502, dt. 18.02.2013	-
8	Pollo k. Balla Vendimi nr.4424, dt. 13.02.2012	-
9	Kokëdhima k. Olldashi Vendimi nr.1628, dt. 4.3.2011	-
10	Shoqëria "Ferar" k. Valikaj (Felaj) Vendimi nr.4291, dt. 24.5.2011	-
11	Ruli k. Tahirit Vendimi nr.1468, dt. 18.2.2013	700.000 lekë.
12	Boga k. Panorama Group, Rakiplari Vendimi nr.12571, dt. 16.12.2013	2.00.000 lekë
13	Marku k. Kaso, gazeta Republika Vendimi nr.8654, dt. 23.7.2013	500.000 lekë

14	Kuliçaj k. Tahiri Vendimi nr.9804, dt. 2.10.2013	-
15	Malltezi k. Balla Vendimi nr.8144, dt.12.7.2013	1000.000 lekë
16	Malltezi, Berisha k. Tahiri Vendimi nr.6538, dt.25.6.2012	1000.000 lekë
17	Vokshi k. Braçe Vendimi nr.1072, dt.9.2.2012	1000.000 lekë
18	Bashkia Tiranë k. Dalipi Vendimi nr.8802, dt.1.10.2012	1000.000 lekë
19	Pango k. Top Channel sh.a Vendimi nr.3806, dt.24.3.2014	-
20	Begeja etj k. Balla Vendimi nr.8414, dt.12.7.2013	-
21	Perlesha k. Gazetës Zëri i Popullit Vendimi nr.7045, dt. 21.06.2013	-
22	Breçani k. Shoqëria Focus Press dhe Focus Media News shpk Vendimi nr.10257 dt. 30.11.2012	3 000.000 lekë
23	Vokshi k. Tahiri Vendimi nr.16, dt.11.1.2013	1000.000 lekë
24	Veliaj k. Goxhaj Vendimi nr.2897, dt.3.7.2014 (Gjykata e Apelit Tiranë)	300.000 leke
25	Malltezi k. Balla Vendimi nr.5571, dt.16.9.2014 (Gjykata e Apelit Tiranë)	-
26	Begeja etj k. Balla Vendimi nr.11354, dt.13.11.2013	-
27	Malltezi, Berisha k. Tahiri Vendimi nr.3011, dt.21.12.2012 (Gjykata e Apelit)	1.000.000 lekë

28	Shoqëria tregtare STSA Albania k. Shoqëria tregtare Shqiptarja.com Vendimi nr.2975, dt.1.12.2014 (çështje penale)	
29	Shoqëria "Bella Confex"shpk, Bazhdari k. Zyra për mbrojtjen e konsumatorit, Goxhaj Vendimi nr.570, dt.24.03.2014 (penale)	-
30	Jani k. Selamaj Vendimi nr.1249, dt.21.09.2012 (penale)	-
31	Kokëdhima k. Berishës Vendimi nr.7, dt.07.06.2010 (Kolegji Penal i GJL)	-
32	Peza k. Berishës Vendimi nr.11, dt.20.01.2012 (Kolegji Penal i GJL)	-
33	Rama k. Berishës Vendimi nr.8, dt.01.07.2011 (Kolegji Penal i GJL)	-
34	Malltezi, Berisha k. Tahiri Vendimi nr.3011, dt.21.12.2012 (Gjykata e Apelit)	-